



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.190

dhjetor

2007

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Udhëzim i MMPAU nr.5, datë 28.12.2007	Për tarifat e shërbimit për lejet mjedisore 6093
Udhëzim i MMPAU nr. 6, datë 27.11.2007	Për miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta 6096
Udhëzim i Përbashkët i MMPAU dhe METE nr. 6, datë 9.10.2007	Për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për cilësinë e benzinës dhe të diezELIT 6107
Udhëzim i MMPAU dhe MSH nr.8, datë 27.11.2007	Për nivelet kufi të zhurmave në mjedisë të caktuara 6108
Rregullore e MMPAU dhe MPPTT nr.1, datë 30.3.2007	Për trajtimin e mbetjeve të ndërtimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre 6110
Rregullore e MMPAU dhe MSH nr.6, datë 30.11. 2007	Për administrimin e mbetjeve spitalore 6117

UDHËZIM
Nr.5, datë 28.12.2007

PËR TARIFAT E SHËRBIMIT PËR LEJET MJEDISORE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 1 të nenit 43 të ligjit nr. 8934, datë 5.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”,

UDHËZOJ:

1. Angazhimet e agjencive rajonale të mjedisit dhe të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për shqyrtimin e kërkesës dhe marrjen e vendimit për lejet mjedisore, vlerësohen si shërbime ndaj të tretëve dhe paguhen nga kërkuesi në formën e tarifave të shërbimeve.

2. Vlera e tarifës përfshin shpenzimet administrative, si dhe të gjitha veprimtaritë konkrete të agjencive rajonale të mjedisit dhe të Ministrisë gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesës për miratimin e projektit dhe të dokumentacionit shoqërues dhe marrjes së vendimit përkatës.

3. Tarifa e paguar është e pakthyeshme, pavarësisht nga fakti, nëse kërkesa miratohet ose jo përfundimisht nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

4. Tarifa duhet të jetë e paguar në momentin e dorëzimit të dokumentacionit e të regjistrimit të tij në protokoll.

5. Tarifa e shërbimit paguhet edhe për veprimtaritë me karakter vendor që ndikojnë në mjedis dhe që miratohen nga agjencitë rajonale të mjedisit në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore dhe që pajisen me autorizim mjedisor ose pëlqim mjedisor.

6. Tarifa derdhet nga propozuesi në bankë, në adresën: Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Raiffeisen Bank, nr.llogarie 317/4302, përshkrimi; tarifë për deklaratë mjedisore, leje mjedisore, autorizim mjedisor ose pëlqim mjedisor (sipas rastit).

7. Shpenzimet e përgatitjes së raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të diskutimit publik, të shqyrtimit dhe këshillimit, përballohen nga propozuesi. Këto shpenzime nuk janë pjesë e tarifës së shërbimit.

8. Përcaktimi i tarifës së shërbimit bëhet mbi bazën e kohës dhe mjeteve të shpenzuara gjatë procesit të shqyrtimit dhe marrjes së vendimit. Këtu përfshihen: shqyrtimi fillestar i dokumentacionit, klasifikimi i kërkesës për të vendosur nëse projekti do t'i nënshtrohet procesit të thelluar apo të përmbledhur të vlerësimit të ndikimit në mjedis, asistencë për subjektet që aplikojnë, komunikimet me organet që japin lejet e ndërtimit dhe të veprimtarisë, organet e qeverisjes vendore, inspektimin e vendit, këshillimin me organet e qeverisjes vendore, të zhvillimit urban dhe turistik, dhënien e mendimit dhe kushtet që duhen vendosur, përcjellja në Ministri, shqyrtimi në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, këshillimi me palët e interesuara, debati publik, shqyrtimi në komisionin e shqyrtimit të kërkesave dhe marrja e vendimit deri në publikimin e tij.

9. Projektet dhe veprimtaritë e shtojcës 1 të ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe strategjitë e planet e veprimtaritë për energjetikën, minierat, industrinë, transportin, bujqësinë, pyjet, për administrimin e burimeve natyrore dhe të pasurive minerale dhe për administrimin e mbeturinave, planet kombëtare dhe rajonale të rregullimit të territorit, për qendrat e zonat urbane dhe rurale, për zonat industriale, për zonat bregdetare, për zonat turistike, për zonat e mbrojtura dhe zonat me ndjeshmëri të lartë ndaj ndotjes dhe dëmtimit, kanë tarifa më të larta. Projektet dhe veprimtaritë e shtojcës 2 të ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” kanë tarifa relativisht më të ulëta. Projektet dhe veprimtaritë me karakter vendor që ndikojnë në mjedis dhe që pajisen me autorizim mjedisor ose pëlqim mjedisor, kanë tarifa më të ulëta.

10. Projektet dhe veprimtaritë që kryhen për mbrojtjen e mjedisit ose që jepen si ndihmë për Shqipërinë, përjashtohen nga tarifa e shërbimit për dhënien e lejes mjedisore dhe leja mjedisore u akordohet falas.

11. Mbështetur në kriteret e mësipërme, për dhënien e deklaratës mjedisore, tarifa e shërbimit është 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

12. Për dhënien e lejeve mjedisore do të aplikohen këto tarifa shërbimi:

a) Tarifa e shërbimit për lejen mjedisore të projekteve dhe veprimtarive në industrinë energjetike, si: rafineritë e naftës dhe të gazit; lëngëzimi dhe përpunimi i qymyrit dhe rërave bituminoze, impiante për rigjenerimin e vajrave të përdorura; hidrocentrale; termocentrale; depozita të mëdha për magazinimin për qëllime tregtimi apo ruajtje për naftën, nënproduktet e saj dhe produktet kimike, impiante industriale për prodhimin e energjisë, avullit dhe ujit të nxehtë; uzina për gazifikimin dhe lëngëzimin e qymyrit dhe të rërave bituminoze etj., kur projekti apo veprimtaria i përket shtojcës 1 të ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, tarifa është 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, kur ato i përket shtojcës 2 të po këtij ligji, tarifa është 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

b) Tarifa e shërbimit për lejen mjedisore të prodhimit dhe përpunimit të metaleve, si: uzina të shkrirjes së mineraleve, kalçinimi dhe pjekja e mineraleve që përmbajnë elemente toksike, uzinat për prodhimin e gizës dhe çelikut, uzinat ose fonderitë për përpunimin e hekurit, fonderitë, uzina për trajtimet sipërfaqësore të metaleve dhe materialeve plastike; prodhimi i hekurit të kuq dhe çelikut me derdhje të vazhdueshme, shfrytëzimi i minierave të mineraleve metalore, fabrikat e pasurimit të mineraleve etj., kur projekti apo veprimtaria i përket shtojcës 1 të ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, tarifa është 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, kur ato i përket shtojcës 2 të po këtij ligji, tarifa është 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

c) Tarifa e shërbimit për lejen mjedisore të nxjerrjes dhe përpunimit të materialeve bazë që nuk kanë në përbërje minerale xeherore, si: prodhimi dhe përpunimi i aliazheve për metale jo ferrike, nxjerrja dhe përpunimi i qymyrit, linjtit dhe mineraleve bitumene, nxjerrja e naftës e gazit natyror, fabrika për prodhimin e çimentos, gëlqeres, qelqit, përfshirë fibrat e xhamit; fonderitë për shkrirjen e substancave minerale, përfshirë prodhimin e fibrave minerale, fabrika për prodhimin e qeramikës; guroret dhe minierat e hapura të argjilave ose nxjerrja e torfes, nxjerrja e mineral-inerteve nga drenazhimi detar dhe lumor, shpimet e thella, nxjerrja e qymyrit, naftës, gazit natyror dhe rërës bituminoze, shkrirja fillestare dhe prodhimi i gizës dhe çelikut etj., kur projekti apo veprimtaria i përket shtojcës 1 të ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, tarifa është 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, kur ato i përket shtojcës 2 të po këtij ligji, tarifa është 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

d) Tarifa e shërbimit për lejen mjedisore të projekteve dhe veprimtarive në industrinë kimike, si: prodhimi i kimikateve organike dhe inorganike bazë, prodhimi i plehrave me bazë fosfatike ose fosfatike azotike, prodhimi i produkteve me bazë bimore, impiantet që përdorin proceset kimike ose biologjike për prodhimin e produkteve me bazë farmaceutike, bojërave dhe pesticideve, impiantet kimike që prodhojnë lëndët shpërthyesë, shtesa ushqimore proteinike, fermente, trajtimi i produkteve të ndërmjetme dhe prodhimi i kimikateve etj., kur projekti apo veprimtaria i përket shtojcës 1 të ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, tarifa është 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, kur ato i përket shtojcës 2 të po këtij ligji, tarifa është 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

e) Tarifa e shërbimit për lejen mjedisore të projekteve dhe veprimtarive të industrisë ushqimore, si: prodhimi i vajrave dhe yndyrave shtazore dhe bimore, përpunimi dhe ambalazhimi i produkteve bimore, prodhimi i produkteve bulmetore, prodhimi i birrës, prodhimi i shurupeve dhe ëmbëlsirave, fabrikat e peshkut dhe vajit të peshkut, fabrikat e sheqerit, prodhimi i pijeve joalkoolike, prodhimi i produkteve ushqimore, fabrikat e blojës, siloset dhe fabrikat e prodhimit të ushqimeve për blegtorinë, thertoret etj., kur projekti apo veprimtaria i përket shtojcës 1 të ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, tarifa është 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, kur ato i përket shtojcës 2 të po këtij ligji, tarifa është 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

f) Tarifa e shërbimit për lejen mjedisore të projekteve dhe veprimtarive të industrisë tekstile, të lëkurëve, të drurit dhe letrës, si: prodhimi i fibrave të kartonit nga druri ose materiale me fibra të ngjashme, impiante industriale për prodhimin e pulpës nga lëndët drusore ose fibrave të tjera të ngjashme, letrës dhe kartonave, paratrajtimin ose lyerjen e fibrave dhe tekstileve, trajtimin e lëkurëve dhe thundrave, përpunimin dhe prodhimin e celulozës, prodhimin e mobilieve etj., kur projekti apo veprimtaria i përket shtojcës 1 të ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, tarifa është 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, kur ato i përket shtojcës 2 të po këtij ligji, tarifa është 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

g) Tarifa e shërbimit për lejen mjedisore të projekteve dhe veprimtarive të industrisë së gomës, si: prodhimi dhe përpunimi i produkteve me bazë rezinash natyrore dhe sintetike, riaftësimi i gomave të përdorura, kur projekti apo veprimtaria i përket shtojcës 1 të ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, tarifa është 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, kur ato i përkasin shtojcës 2 të po këtij ligji, tarifa është 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

h) Tarifa e shërbimit për lejen mjedisore të projekteve dhe veprimtarive të administrimit të mbetjeve, si: impiante për përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme apo të mbetjeve urbane, impiante për përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve të degëve të ndryshme të industrisë, vendgroposjet (landfillet), vendet e depozitimit të mbetjeve industriale, vendet e depozitimit të inerteve, impiantet e përpunimit të mbetjeve të blegtorisë, shpendëve e peshkut etj., kur projekti apo veprimtaria i përket shtojcës 1 të ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, tarifa është 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë, kur ato i përkasin shtojcës 2 të po këtij ligji, tarifa është 8 000 (tetë mijë) lekë.

i) Tarifa e shërbimit për lejen mjedisore të projekteve dhe veprimtarive të tjera (impiante të ndryshme) për: testimin e motorëve, turbinave, reaktorëve, shkatërrimin e lëndëve eksplozive, për prodhimin e fibrave minerale artificiale (betoneve); për rritjen intensive të shpendëve, derrave e bagëtive të imta; rrugë për testimin dhe garat e mjeteve të motorizuara; projekte të fushës së mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, depo etj.; bujqësi, silvikulturë dhe akuakulturë: dhe shpyllëzimi; menaxhimi i ujërave për nevoja bujqësore; fermat e peshkimit; marrja e tokës nga deti; rregullimet e lumenjve etj., projekte të infrastrukturës: projekte të zhvillimit industrial, urban; të qendrave të blerjes dhe parkimet e automjeteve, ndërtimi i linjave hekurudhore, aeroporteve, rrugëve, porteve, rrugëve ujore në brendësi të tokës, tramvajeve, dampave dhe rezervuarëve, ndërtimi i ujësjellësve, nxjerrja e ujërave nëntokësore dhe skemat e rimbushjes artificiale të ujërave nëntokësore, projekte për transferimin e burimeve ujore midis baseneve të lumenjeve, akuadukte etj., teleferikët e skive, portet turistike, fshatrat turistike dhe komplekset e hoteleve jashtë zonave urbane dhe të zhvillimeve të shoqëruara me këto lloj veprimtarish, zona të karavaneve dhe kampeve, parqet zbatimëse, rrjetet dhe antenat elektromagnetike jojonizuese, si dhe sistemet e transmetimit elektrik është 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

13. Në dhënien e autorizimeve mjedisore do të aplikohen këto tarifa shërbimi:

Tarifa e shërbimit për veprimtaritë e aneksit të I-rë të udhëzuesit nr.2, datë 21.5.2007 “Për miratimin e listës së veprimtarive me ndikim në mjedis, mënyrën e aplikimit dhe rregullat e procedurat e dhënies së autorizimit dhe pëlqimit mjedisor” grupohen si më poshtë:

a) për veprimtaritë e të gjitha pikave të aneksit të I-rë të udhëzuesit, tarifa e shërbimit është 10 000 (dhjetë mijë) lekë, me përjashtim të veprimtarive të pikave 4, 5, 8, 9, 15, 17, 19, 21, 25, 26, 27, 28, 29, 32, 34, 35 të aneksit tarifa e të cilave është 20 000 (njëzet mijë) lekë.

14. Në dhënien e pëlqimeve mjedisore, do të aplikohen këto tarifa shërbimi:

Tarifa e shërbimit për veprimtaritë e aneksit të II-të, të udhëzuesit nr.2, datë 21.5.2007 “Për miratimin e listës së veprimtarive me ndikim në mjedis, mënyrën e aplikimit dhe rregullat e procedurat e dhënies së autorizimit dhe pëlqimit mjedisor” grupohen si më poshtë:

a) për veprimtaritë e të gjitha pikave të aneksit të II-të të udhëzuesit, tarifa e shërbimit është 2 000 (dy mijë) lekë, me përjashtim të pikës 1, dhe 10 tarifa e të cilave është 1000 (një mijë) lekë.

15. Tarifa e shërbimit për përtëritje të lejeve dhe autorizimeve mjedisore do të jetë sa gjysma e tarifës për marrjen e lejes sipas këtij udhëzimi.

16. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, udhëzimi nr.1, datë 30. 11.2005 “Për përcaktimin e tarifave të lejeve të mjedisit”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Lufter Xhuveli

UDHËZIM
Nr.6, datë 27.11.2007

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE, PËRMBAJTJES DHE AFATEVE
PËR PËRGATITJEN E PLANEVE TË ADMINISTRIMIT TË MBETJEVE TË NGURTA**

Në bazë të nenit 102/4 të Kushtetutës dhe të nenit 66/ç të ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”,

UDHËZOJ:

1. Përgatitja e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal realizohet sipas rregullave, procedurave dhe afateve të përcaktuara në këtë udhëzim dhe në anekset 1, 2 dhe 3 bashkëlidhur.

Plani Kombëtar i Administrimit të Mbetjeve të Ngurta:

2. Plani kombëtar hartohet në përputhje me kërkesat e legjislacionit mjedisor dhe të strategjisë kombëtare të mjedisit.

3. Plani kombëtar synon të zbatojë hierarkinë e mëposhtme të administrimit të mbetjeve:

- a) parandalimi/minimizimi i mbetjeve që në burim;
- b) minimizimi (sa më shumë që të jetë e mundur) i karakteristikave të rrezikshme të tyre;
- c) riciklimi i tyre;
- d) rikuperimi i materialeve dhe i energjisë prej mbetjeve;
- e) asgjësimi i sigurtë i mbetjeve.

4. Plani kombëtar përmban të paktën elementet në vazhdim:

a) kërkesat ligjore dhe teknike që duhen plotësuar për administrimin e mbetjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë, në të gjitha fazat (përfshirë grumbullimin, transportimin, trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve të veçanta) sipas legjislacionit vendas, atij të BE-së dhe sipas teknikave më të mira të disponueshme (BAT);

b) llojin, sasinë dhe origjinën e mbetjeve të ngurta, prej nga rrjedhin, nga importohen dhe në rastet e transitimit përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, ndërmjet cilave vendeve këmbehen;

c) rritjen e parashikuar të volumit të mbetjeve që do të grumbullohen, trajtohen dhe asgjësohen në periudhën afatshkurtër (5-vjeçare), afatmesme (10-vjeçare) dhe afatgjatë (20-vjeçare);

d) rrjetin e integruar të impianteve të asgjësimit të mbetjeve në vend;

e) objektivat specifike (afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata), masat që duhen marrë për përmbushjen e objektivave në afatet e caktuara dhe për monitorimin e mbetjeve;

f) vlerësimin e kostove dhe investimeve të nevojshme për zbatimin e planit, si dhe burimet e mundshme të financimit;

g) masat e nevojshme për informimin, ndërgjegjësimin e vazhdueshëm të publikut dhe pjesëmarrjen e tij në vendimmarrje;

h) informacione dhe masa të tjera.

5. Plani kombëtar fillestar hartohet për një periudhë të paktën dhjetëvjeçare. Planet e tjera të mëvonshme do të hartohen për periudha pesëvjeçare.

6. Plani kombëtar miratohet brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

7. Nën drejtimin e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, ministritë e linjës dhe institucionet e tjera të qeverisjes qendrore apo vendore bashkëpunojnë për hartimin e planit kombëtar të administrimit të mbetjeve të ngurta sipas kërkesave të këtij udhëzimi. Në rastin kur plani kombëtar hartohet me konsulencë të huaj, ato mbështesin me të dhëna dhe ndihmojnë aktivisht në koordinimin dhe lehtësimin e procesit të hartimit të tij.

Planet rajonale të administrimit të mbetjeve të ngurta:

8. Plani rajonal hartohet brenda një viti nga miratimi i planit kombëtar të administrimit të mbetjeve të ngurta, në përputhje me parimet, objektivat dhe synimet e caktuara prej tij.

9. Plani rajonal hartohet për një periudhë kohore jo më pak se 10 vjet. Plani rajonal

rishikohet dhe përmirësohet çdo 5 vjet.

10. Plani rajonal specifikon masat që duhen marrë nga organet e qeverisjes vendore në zbatim të objektivave të planit kombëtar të administrimit të mbetjeve të ngurta.

11. Plani rajonal përmban objektiva specifike si më poshtë:

a) Të realizojë objektivat e planit kombëtar të administrimit të mbetjeve të ngurta brenda territorit të rajonit;

b) të parandalojë ose minimizojë prodhimin apo rrezikshmërinë e mbetjeve;

c) të nxisë dhe mbështesë përdorimin, përpunimin dhe riciklimin e mbetjeve;

d) të sigurojë që këto mbetje (në rastet kur nuk mund të parandalohen apo riciklohen) të asgjësohen pa rrezikuar shëndetin e njerëzve dhe mjedisin;

e) të përforcojë bashkëpunimin ndërmjet qeverisë lokale dhe rajoneve në të gjithë territorin e vendit;

f) të sigurojë financimin e qëndrueshëm të masave të planit, përmes zbatimit të parimit, ndotësi paguan dhe parimit të rimbursimit të plotë të kostos;

g) të përforcojë bashkëpunimin ndërmjet sektorëve publikë dhe privatë në administrimin e mbetjeve.

12. Plani rajonal rregullon mënyrën e monitorimit të masave që merren në zbatim të tij.

13. Në procesin e hartimit të planit rajonal, këshilli i qarkut realizon informimin dhe konsultohet me publikun sipas kërkesave të ligjit nr.8990, datë 23.1.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

14. Në rast se është e domosdoshme, brenda një viti nga miratimi i planit kombëtar, këshilli i qarkut përmirëson planin rajonal që të jetë në përputhje me planin kombëtar.

15. Për rishikimin dhe përmirësimin e planit rajonal, këshilli i qarkut siguron që ky plan të jetë në përputhje me:

a) të gjitha planet e veta për mjedisin, për tokën apo për zhvillimin;

b) planet kombëtare për mjedisin, tokën apo zhvillimin;

c) planet e ngjashme të qarqeve kufizuese të territorit të tij ose vendimet e marra në organet e qeverisjes vendore të tyre.

Planet bashkiake/komunale të administrimit të mbetjeve të ngurta:

16. Plani i bashkisë/komunës hartohet brenda një viti nga miratimi i planit rajonal, në zbatim të planit rajonal dhe planit kombëtar dhe në përputhje me to.

17. Plani i bashkisë/komunës hartohet për mbetjet e gjeneruara brenda territorit në juridiksionin e vet.

18. Plani i bashkisë/komunës rregullon një periudhë kohore jo më pak se 10 vjet dhe rishikohet pas pesë vitesh.

19. Plani i bashkisë/komunës rregullon mënyrën e monitorimit të masave që merren në zbatim të tij.

20. Plani i bashkisë/komunës përmban objektiva specifike që bashkia/komuna i konsideron të domosdoshëm, si:

a) parandalimi/minimizimi i gjenerimit të mbetjeve që në burim;

b) reduktimi i rrezikut të tyre;

c) nxitja dhe mbështetja e aktiviteteve të përpunimit të mbetjeve;

d) sigurimi i grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve në përputhje me legjislacionin në fuqi sipas ligjit nr.8094, datë 21.3.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”;

e) këmbimi i informacionit në rrjet dhe sigurimi i të dhënave të nevojshme për këshillin e qarkut;

f) identifikimi i metodave ekonomikisht të përballueshme dhe ekologjikisht të pranueshme për përpunimin/riciklimin/rekuperimin e mbetjeve të ngurta dhe kur kjo nuk është e mundur, asgjësimi i sigurt i tyre pa dëmtuar shëndetin e njerëzve dhe mjedisin;

g) thellimi i bashkëpunimit midis sektorit publik dhe privat për administrimin e mbetjeve;

h) forcimi i bashkëpunimit ndërmjet organeve të qeverisjes vendore në të gjithë territorin e vendit;

i) sigurimi i financimeve të qëndrueshme për masat e planit, përmes zbatimit të parimit

ndotësi paguan dhe parimit të rimbursimit të plotë të kostos;

ii) ngritja e një sistemi për informimin dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje.

21. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe organet e qeverisjes vendore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Lufter Xhuveli

ANEKS 1 PLANI KOMBËTAR

Plani kombëtar i administrimit të mbetjeve të ngurta përfshin një vlerësim bazë të situatës aktuale të administrimit të mbetjeve të ngurta në Republikën e Shqipërisë.

1. Vlerësimi bazë bëhet mbi informacionin dhe analizat e mëposhtme:

a) paraqitjen e politikave përkatëse kombëtare, rajonale dhe lokale;

b) paraqitjen e legjisllacionit, të programeve dhe praktikave që kanë lidhje me administrimin e mbetjeve të ngurta;

c) paraqitjen e politikave të Bashkimit Europian, *Acquis* përkatës dhe programet që ai mbështet;

d) paraqitjen e marrëveshjeve ndërkombëtare të vendit në fushën e administrimit të mbetjeve;

e) përshkrimin e popullsisë dhe territorit sipas pozitës gjeografike, gjeologjisë, hidrologjisë, natyrës, zonave të mbrojtura, kushteve klimaterike, infrastrukturës, zhvillimit industrial;

f) situata social-ekonomike dhe degët e ekonomisë së vendit;

g) institucionet dhe organizatat që merren me administrimin e mbetjeve në qeverisjen kombëtare dhe lokale.

2. Situata, zhvillimet dhe karakteristikat e administrimit të mbetjeve të ngurta:

a) volumi në m³ dhe ton, për çdo lloj mbetjesh të gjeneruara në periudhën 2000-2007, sipas:

b) kodit të mbetjeve*;

c) emrit përkatës*;

d) kategorisë së mbetjeve*;

e) volumi në m³, ton dhe % i mbetjeve të ngurta të kontaminuara me ndotës/substanca të rrezikshme;

f) volumi në m³, ton dhe % i mbetjeve të tjera;

g) totali në m³ dhe ton i mbetjeve të gjeneruara në të gjithë vendin;

h) volumi në m³, ton dhe % i mbetjeve të ricikluara;

i) volumi në m³, ton dhe % i mbetjeve të përdorura për rekuperim të materialeve dhe energjisë;

* sipas emërimit në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.99, datë 18.2.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve" dhe listave të mbetjeve që lejohet të importohen në Republikën e Shqipërisë për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi.

* sipas emërimit në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.99, datë 18.2.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve" dhe listave të mbetjeve që lejohet të importohen në Republikën e Shqipërisë për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi.

* sipas emërimit në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.99, datë 18.2.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve" dhe listave të mbetjeve që lejohen të importohen në Republikën e Shqipërisë për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi.

- j) volumi në m^3 , ton dhe % i mbetjeve të asgjësuar;
 - k) volumi në m^3 , ton dhe % të asgjësuar përmes djegies/incinerimit;
 - l) volumi në m^3 , ton dhe % i mbetjeve të depozituara në venddepozitim/landfill;
 - m) të tjera.
3. Përpunimi dhe impiantet operative të asgjësimit të mbetjeve (përveç depozitimit):
- a) lloji i impiantit;
 - b) emri dhe vendi i përdoruesit;
 - c) adresa e përdoruesit (adresë postare, telefon, celular, fax, e-mail);
 - d) personi i kontaktit;
 - e) zona kadastrale dhe vendndodhja e impiantit;
 - f) viti i fillimit të veprimtarisë;
 - g) lloji i mbetjeve të përpunuara;
 - h) lloji i mbetjeve të asgjësuar;
 - i) kapaciteti i impiantit;
 - j) sasia e mbetjeve të përpunuara në ton/vit dhe m^3 /vit;
 - k) sasia e mbetjeve të asgjësuar në ton/vit dhe m^3 /vit.
4. Për dampat/venddepozitimet dhe landfillet operative dhe ato në ndërtim e sipër, do të jepen të dhënat e mëposhtme:
- a) qarku;
 - b) rrethi;
 - c) emri i vendit të depozitimit;
 - d) përdoruesi i vendit të depozitimit;
 - e) adresa e përdoruesit (adresë postare, telefon, celular, fax, e-mail);
 - f) personi i kontaktit;
 - g) zona kadastrale dhe vendndodhja;
 - h) përshkrimi i vendit të depozitimit;
 - i) data e parashikuar për fillimin e përdorimit të venddepozitimit;
 - j) data e parashikuar për përfundimin e përdorimit të venddepozitimit;
 - k) data e parashikuar për mbylljen apo riaftësimin e venddepozitimit operativ;
 - l) zona e venddepozitimit dhe zona e depozitimit në m^2 ;
 - m) kapaciteti total i venddepozitimit në ton dhe m^3 ;
 - n) sasi të mbetjeve të depozituara gjatë vitit 2007 në ton dhe m^3 ;
 - o) kapaciteti i mbetur i venddepozitimit në ton dhe m^3 ;
 - p) llojet e mbetjeve (sipas klasifikimeve në dokumentet e përmendura në pikën 3/b).
 - q) të dhëna të tjera për zonën e grumbullimit të mbetjeve;
 - r) të dhëna për lejen e mjedisit të venddepozitimit/landfillit.
5. Të dhëna për transportuesit e mbetjeve që veprojnë në territor, rajon ose rreth:
- a) emri i transportuesit;
 - b) lloji i autorizimit që disponon;
 - c) data e fillimit të veprimtarisë si transportues;
 - d) selia;
 - e) adresa;
 - f) personi i kontaktit (adresë postare, telefon, celular, fax, e-mail);
 - g) lloji i mbetjeve që transporton;
 - h) kapaciteti mesatar i sasive të mbetjeve të transportuara gjatë vitit kalendarik në ton dhe m^3 .
6. Pjesa e planit kombëtar për periudhat e ardhshme do të paraqesë detajet e mëposhtme. Prodhimi i parashikuar i mbetjeve dhe përqindja e riciklimit, rekuperimit, incinerimit dhe landfillimit në vite. Të dhënat jepen sipas:
- a) kodit, emrit dhe kategorisë së mbetjeve si më lart;
 - b) volumit në m^3 dhe ton i totalit të mbetjeve që parashikohen të gjenerohen në territorin e vendit për çdo vit të periudhës së mbuluar nga plani;

c) volumi në m³, ton dhe % të mbetjeve që parashikohen të riciklohen në raport ndaj totalit të mbetjeve;

d) volumi në m³, ton dhe % të mbetjeve që parashikohen të recuperohen në raport ndaj totalit të mbetjeve;

e) volumi në m³, ton dhe % të mbetjeve që parashikohen të asgjësohen në raport ndaj totalit të mbetjeve;

f) volumi në m³, ton dhe % i mbetjeve që parashikohen të asgjësohen, përmes djegies/incinerimit në raport ndaj totalit të mbetjeve;

g) volumi në m³, ton dhe % i mbetjeve që parashikohen të depozitohen në vend-depozitim/landfill në raport ndaj totalit të mbetjeve;

h) të tjera;

i) metoda e parashikimit dhe supozimet, mbi të cilat janë bazuar parashikimet; veç të tjerash parashikimi duhet bërë mbi bazën e vlerësimit të planit për periudhat e shkuara, qëllimet e prodhuesve të mbetjeve dhe të planeve të biznesit në fushën e administrimit të mbetjeve në vend;

j) masat afatshkurtra (1-5vjet), afatmesme (6-10 vjet) dhe afatgjata (11-20 vjet).

7. Objektivat, qëllimet, masat dhe afatet përmbledhen në formatin e mëposhtëm:

Objektivat	Qëllimet	Masat	Treguesit e suksesit

a) Afatet dhe aktivitetet për masat afatgjata dhe afatmesme përmbledhen në formatin e mëposhtme:

Objektivat					
Nr.	Masat	Institucionet/ personat përgjegjës	Afati	Vitet	Buxheti i nevojshëm

8. Pikat e forta dhe të dobëta të situatës aktuale të administrimit të mbetjeve, të legjislacionit, institucioneve, procedurave, të cilat do të përmbledhen në tabelën e mëposhtme:

Aspektet	Pikat e forta dhe të dobëta	Arsyet për pikat e forta dhe të dobta	Pasojat

9. Seksioni financiar mbulon minimalisht sa më poshtë:

a) pasojat ekonomike të çdo mase të parashikuar;

b) investimet e parashikuara për administrimin e mbetjeve;

c) kostot administrative të parashikuara për administrimin e mbetjeve;

d) burimet e propozuara të financimit, përfshirë çmimet, taksat, tarifatat dhe të ardhurat prej tyre, subvencione të mundshme etj.

10. Rezultatet e monitorimit të zbatimit të planit përmbledhen në formatin e mëposhtëm:

Treguesit	Rëndësia	Burimet e informacionit	Frekuenca e monitorimit

11. Të tjera:

a) vlerësimi i komenteve të paraqitura nga publiku dhe grupet e interesit;

b) dokumente të vlerësimit strategjik mjedisor.

ANEKS 2 PLANI RAJONAL

Plani rajonal përmban të dhëna si më poshtë:

1. informacion bazë për administrimin e mbetjeve të ngurta në nivel rajonal:
 - a) emri i autoritet/eve që miratojnë planin;
 - b) selia/selitë e autoritet/eve që miratojnë planin;
 - c) numri i banorëve në territorin që rregullon plani;
 - d) përcaktimi i territorit;
 - e) karakteristikat ekologjike të territorit (p.sh. park kombëtar, zonë e mbrojtur ujore/tokësore etj.);
 - f) struktura ekonomike e territorit të rregulluar nga plani dhe në veçanti prodhimi i mbetjeve.
2. Situata, zhvillimet dhe karakteristikat e administrimit të mbetjeve të ngurta:
 - a) Volumi në m³ dhe ton, për çdo lloj mbetjesh të gjeneruara në territorin e atij qarku në periudhën 2000-2007, sipas:
 - b) kodit të mbetjeve* ;
 - c) emrit përkatës*;
 - d) kategorisë së mbetjeve*;
 - e) volumi në m³, ton dhe % i mbetjeve të ngurta të kontaminuara me ndotës/substanca të rrezikshme;
 - f) volumi në m³ dhe ton i mbetjeve të tjera;
 - g) totali në m³ dhe ton i mbetjeve të gjeneruara në të gjithë vendin;
 - h) volumi në m³, ton dhe % i mbetjeve të ricikluara;
 - i) volumi në m³, ton dhe % i mbetjeve të përdorura për rekuperim të materialeve dhe energjisë;
 - j) volumi në m³, ton dhe % i mbetjeve të asgjësuara;
 - k) volumi në m³, ton dhe % i mbetjeve të asgjësuara përmes djegies/incinerimit;
 - l) volumi në m³, ton dhe % i mbetjeve të depozituara në venddepozitim/landfill;
 - m) të tjera.
 3. Përpunimi dhe impiantet operative të asgjësimit të mbetjeve (përveç depozitimit):
 - a) lloji i impiantit;
 - b) emri dhe vendi i përdoruesit;
 - c) adresa e përdoruesit (adresë postare, telefon, celular, fax, e-mail);
 - d) personi i kontaktit;
 - e) zona kadastrale dhe vendndodhja e impiantit;
 - f) viti i fillimit të veprimtarisë;
 - g) lloji i mbetjeve të përpunuara;
 - h) lloji i mbetjeve të asgjësuara;
 - i) kapaciteti i impiantit;

*sipas emërimit në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve” dhe listave të mbetjeve që lejohet të importohen në Republikën e Shqipërisë për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi.

*sipas emërimit në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve” dhe listave të mbetjeve që lejohet të importohen në Republikën e Shqipërisë për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi.

*sipas emërimit në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve” dhe listave të mbetjeve që lejohet të importohen në Republikën e Shqipërisë për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi.

j) sasia e mbetjeve të përpunuara në ton/vit dhe m^3/vit ;

k) sasia e mbetjeve të agjësuar në ton/vit dhe m^3/vit ;

l) të dhëna për lejen e mjedisit të impiantit.

4. Për dampat/venddepozitimet dhe landfillet operative dhe ato në ndërtim e sipër, jepen të dhënat e mëposhtme:

a) qarku;

b) rrethi;

c) emri i vendit të depozitimit;

d) përdoruesi i vendit të depozitimit;

e) adresa e përdoruesit (adresë postare, telefon, celular, fax, e-mail);

f) personi i kontaktit;

g) zona kadastrale dhe vendndodhja;

h) përshkrimi i vendit të depozitimit;

i) data e parashikuar për fillimin e përdorimit të venddepozitimit;

j) data e parashikuar për përfundimin e përdorimit të venddepozitimit;

k) data e parashikuar për mbylljen apo riaftësimin e venddepozitimit operativ;

l) zona e venddepozitimit dhe zona e depozitimit në m^2 ;

m) kapaciteti total i venddepozitimit në ton dhe m^3 ;

n) sasitë e mbetjeve të depozituara gjatë vitit 2007 në ton dhe m^3 ;

o) kapaciteti i mbetur i venddepozitimit në ton dhe m^3 ;

p) llojet e mbetjeve (sipas klasifikimeve në dokumentet e përmendura në pikën 3/b);

q) të dhëna të tjera për zonën e grumbullimit të mbetjeve;

r) të dhëna për lejen e mjedisit të vend-depozitimit/landfillit.

5. Të dhëna për transportuesit e mbetjeve që veprojnë në qarkun ose rrethin përkatës:

a) emri i transportuesit;

b) lloji i autorizimit që disponon;

c) data e fillimit të veprimtarisë si transportues;

d) selia;

e) adresa;

f) personi i kontaktit (adresë postare, telefon, celular, fax, e-mail);

g) lloji i mbetjeve që transporton;

h) kapaciteti mesatar i sasive të mbetjeve të transportuara gjatë vitit kalendarik në ton dhe m^3 .

6. Administrimi i mbetjeve të ngurta në të ardhmen.

Prodhimi i parashikuar i mbetjeve dhe përqindja e riciklimit, rekuperimit, incinerimit dhe landfillimit në vitet e ardhshme jepen sipas:

a) kodit të mbetjeve (sipas emërimit në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve” dhe listave të mbetjeve që lejohen të importohen në Republikën e Shqipërisë për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi;

b) emrit përkatës (sipas dokumenteve të përmendura në pikën 6/a të këtij aneksi);

c) kategorisë së mbetjeve (sipas dokumenteve të përmendura në pikën 6/a të këtij aneksi);

d) volumi në m^3 dhe ton i totalit të mbetjeve që parashikohen të gjenerohen në territorin e qarkut;

e) volumi në m^3 , ton dhe % të mbetjeve që parashikohen të riciklohen në raport ndaj totalit të mbetjeve;

f) volumi në m^3 , ton dhe % të mbetjeve që parashikohen të rekuperohen në raport ndaj totalit të mbetjeve;

g) volumi në m^3 , ton dhe % të mbetjeve që parashikohen të asgjësohen në raport ndaj totalit të mbetjeve;

h) volumi në m^3 , ton dhe % të mbetjeve që parashikohen të asgjësohen, përmes djegies/incinerimit në raport ndaj totalit të mbetjeve;

i) volumi në m^3 , ton dhe % të mbetjeve që parashikohen të depozitohen në venddepozitim/landfill në raport ndaj totalit të mbetjeve;

j) të tjera;

k) metoda e parashikimit dhe supozimet, mbi të cilat janë bazuar parashikimet veç të tjerash parashikimi duhet bërë mbi bazën e vlerësimit të planit për periudhat e shkuara, qëllimet e prodhuesve të mbetjeve dhe të planeve të biznesit në fushën e administrimit të mbetjeve në territorin e rajonit apo të zonës;

l) masat afatshkurtra (1-5 vjet), afatmesme (6-10 vjet) dhe afatgjata (11-20 vjet).

7. Masat organizative, teknike e teknologjike/ operacionale për reduktimin e prodhimit të mbetjeve.

a) masat për reduktimin e mbetjeve që nuk degradohen biologjikisht, që destinohen për t'u depozituar në vendet e depozitimit;

b) elemente të procedurave për reduktimin e mbetjeve që nuk shpërbëhen biologjikisht destinohen për në vendet e depozitimit;

c) të dhëna duhet të jepen për vitin e parë dhe për vitet e tjera të përcaktuara dhe që parashikohen në këtë pikë;

d) të dhënat për vitin e parë të planit jepen në njësinë matëse në m³, ton dhe %.

e) të dhënat për vitet e tjera të përcaktuara në plan jepen në %;

8. Objektivat

Objektivat hartohen për një qark të caktuar dhe përmbajnë të dhëna për:

a) emrin e impiantit ku kryhet riciklimi/asgjësimi etj.;

b) emrin e investitorit;

c) kapacitetin e impiantit;

d) zonën kadastrale dhe vendndodhjen e saj;

e) llojin e mbetjeve që trajtohen;

f) datën e pritshme të realizimit;

g) buxheti dhe burime të tjera financiare dhe ekonomike;

h) vlerësimi strategjik mjedisor;

i) vlerësimi i komenteve nga publiku dhe grupet e interesit.

Objektivat, qëllimet, masat që do të merren dhe treguesit e suksesit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Objektivat	Qëllimet	Masat	Treguesit e suksesit

Masat, përgjegjësitë, afatet dhe buxhetet paraqiten në formatin e mëposhtëm:

Objektivat					
Nr.	Masat	Institucionet/ personat përgjegjës	Afati	Vitet	Buxheti i nevojshëm

9. Pikat e forta dhe të dobëta të situatës aktuale të administrimit të mbetjeve, legjislacioni, institucionet, procedurat, ekonomia, të cilat do të përmbledhen në tabelën e mëposhtme:

Aspektet	Pikat e forta dhe të dobëta	Arsyet për pikat e forta dhe të dobëta	Pasojat

10. Seksioni financiar mbulon minimalisht sa më poshtë:

a) pasojat ekonomike të çdo mase të parashikuar;

b) investimet e parashikuara për administrimin e mbetjeve;

- c) kostot administrative të parashikuara për administrimin e mbetjeve;
- d) burimet e propozuara të financimit, përfshirë çmimet, taksat, tarifatat dhe të ardhurat prej tyre.

11. Rezultatet e monitorimit përmbledhen në formatin e mëposhtëm:

Treguesit mjedisorë	Rëndësia	Burimet e informacionit	Frekuenca e monitorimit

12. Të tjera.

- a) vlerësimi i komenteve të paraqitura nga publiku;
- b) dokumente të vlerësimit strategjik mjedisor.

ANEKS 3 PLANI I BASHKISË/KOMUNËS

Plani i bashkisë/komunës përmban të dhënat si më poshtë:

1. Informacion bazë për administrimin e mbetjeve të ngurta në nivel bashkie/komune:
 - a) emri i autoritet/eve që miratojnë planin;
 - b) selia/selitë e autoritet/eve që miratojnë planin;
 - c) numri i banorëve në territorin që rregullon planin;
 - d) përcaktimi i territorit;
 - e) karakteristikat ekologjike të territorit (p.sh. park kombëtar, zonë e mbrojtur ujore/tokësore etj.);
 - f) struktura ekonomike e territorit të rregulluar nga plani dhe në veçanti prodhimi i mbetjeve.
2. Situata, zhvillimet dhe karakteristikat e administrimit të mbetjeve të ngurta:
 - a) volumi në m³ dhe ton, për çdo lloj mbetjesh të gjeneruara në territorin e asaj bashkie/komune në periudhën 2000-2007, sipas:
 - b) kodit të mbetjeve*;
 - c) emrit përkatës*;
 - d) kategorisë së mbetjeve*;
 - e) volumi në m³, ton dhe % i mbetjeve të ngurta të kontaminuara me ndotës/substanca të rrezikshme;
 - f) volumi në m³, ton dhe % të mbetjeve të tjera;
 - g) totali në m³ dhe ton të mbetjeve të gjeneruara në të gjithë vendin;
 - h) volumi në m³, ton dhe % të mbetjeve të ricikluara;
 - i) volumi në m³, ton dhe % të mbetjeve të përdorura për rekuperim të materialeve dhe energjisë;
 - j) volumi në m³, ton dhe % të mbetjeve të asgjësuara;

* sipas emërimit në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve” dhe listave të mbetjeve që lejohen të importohen në Republikën e Shqipërisë për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi.

* sipas emërimit në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve” dhe listave të mbetjeve që lejohen të importohen në Republikën e Shqipërisë për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi.

* sipas emërimit në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve” dhe listave të mbetjeve që lejohen të importohen në Republikën e Shqipërisë për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi.

- k) volumi m³, ton dhe % të mbetjeve të asgjësuar, përmes djegies/incinerimit;
- l) volumi në m³, ton dhe % të mbetjeve të depozituara në venddepozitim/landfill;
- m) të tjera.

3. Përpunimi dhe impiantet operative të asgjësimit të mbetjeve, (përveç depozitimit):

- a) lloji i impiantit;
- b) emri dhe vendi i përdoruesit;
- c) adresa e përdoruesit (adresë postare, telefon, celular, fax, e-mail);
- d) personi i kontaktit;
- e) zona kadastrale dhe vendndodhja e impiantit;
- f) viti i fillimit të veprimtarisë;
- g) lloji i mbetjeve të përpunuara;
- h) lloji i mbetjeve të asgjësuar;
- i) kapaciteti i impiantit;
- j) sasia e mbetjeve të përpunuara në ton/vit dhe m³/vit;
- k) sasia e mbetjeve të agjësuar në ton/vit dhe m³/vit;
- l) të dhëna për lejen e mjedisit të impiantit.

4. Për dampat/venddepozitimet dhe landfillet operative dhe ato në ndërtim e sipër, jepen të dhëna e mëposhtme:

- a) Bashkia/komuna;
- b) emri i vendit të depozitimit;
- c) përdoruesi i vendit të depozitimit;
- d) adresa e përdoruesit (adresë postare, telefon, celular, fax, e-mail);
- e) personi i kontaktit;
- f) zona kadastrale dhe vendndodhja;
- g) përshkrimi i vendit të depozitimit;
- h) data e parashikuar për fillimin e përdorimit të venddepozitimit;
- i) data e parashikuar për përfundimin e përdorimit të venddepozitimit;
- j) data e parashikuar për mbylljen apo riaftësimin e venddepozitimit operativ;
- k) zona e venddepozitimit dhe zona e depozitimit në m²;
- l) kapaciteti total i venddepozitimit në ton dhe m³;
- m) sasitë e mbetjeve të depozituara gjatë vitit 2007 në ton dhe m³;
- n) kapaciteti i mbetur i venddepozitimit në ton dhe m³;
- o) llojet e mbetjeve;
- p) të dhëna të tjera për zonën e grumbullimit të mbetjeve;
- q) të dhëna për lejen e mjedisit të venddepozitimit/landfillit.

5. Të dhëna për transportuesit e mbetjeve, që veprojnë në bashkinë/komunën përkatëse:

- a) Emri i transportuesit;
- b) lloji i autorizimit që disponon;
- c) data e fillimit të veprimtarisë si transportues;
- d) selia;
- e) adresa;
- f) personi i kontaktit (adresë postare, telefon, celular, fax, e-mail);
- g) lloji i mbetjeve që transporton;
- h) kapaciteti mesatar i sasive të mbetjeve të transportuara gjatë vitit kalendarik në ton dhe

m³.

6. Administrimi i mbetjeve të ngurta në të ardhmen

Prodhimi i parashikuar i mbetjeve dhe përqindja e riciklimit, rekuperimit, incinerimit dhe landfillimit jepen sipas:

- a) Kodit të mbetjeve;
- b) emrit përkatës ;
- c) kategorisë së mbetjeve;
- d) volumi në m³ dhe ton i totalit të mbetjeve, që parashikohen të gjenerohen në territorin e qarkut;

e) volumi në m³, ton dhe % të mbetjeve, që parashikohen të riciklohen në raport ndaj totalit të mbetjeve;

f) volumi në m³, ton dhe % të mbetjeve, që parashikohen të recuperohen në raport ndaj totalit të mbetjeve;

g) volumi në m³, ton dhe % të mbetjeve, që parashikohen të asgjësohen, në raport ndaj totalit të mbetjeve;

h) volumi në m³, ton dhe % të mbetjeve, që parashikohen të asgjësohen përmes djegies/incinerimit në raport ndaj totalit të mbetjeve;

i) volumi në m³, ton dhe % të mbetjeve, që parashikohen të depozitohen në venddepozitim/landfill në raport ndaj totalit të mbetjeve;

j) të tjera;

k) metoda e parashikimit dhe supozimet, mbi të cilat janë bazuar parashikimet, veç të tjerash parashikimi duhet bërë mbi bazën e vlerësimit të planit për periudhat e shkuara, qëllimet e prodhuesve të mbetjeve dhe të planeve të biznesit në fushën e administrimit të mbetjeve në territorin e rajonit apo të zonës.

l) Masat afatshkurtra (1-5vjet), afatmesme (6-10 vjet) dhe afatgjata (11-20 vjet).

7. Masat organizative, teknike e teknologjike/ operacionale për reduktimin e prodhimit të mbetjeve:

a) Masat për reduktimin e mbetjeve që nuk degradohen biologjikisht, që destinohen për t'u depozituar në vendet e depozitimit;

b) elemente të procedurave për reduktimin e mbetjeve që nuk shpërbehen biologjikisht destinohen për në vendet e depozitimit;

c) të dhëna duhet të jepen për vitin e parë dhe për vitet e tjera të përcaktuara dhe që parashikohen në këtë pikë;

d) të dhënat për vitin e parë të planit jepen në njësinë matëse në m³, ton dhe %;

e) të dhënat për vitet e tjera të përcaktuara në plan jepen në %.

8. Objektivat

Objektivat hartohen për një qark të caktuar dhe përmbajnë të dhëna për:

a) Emrin e impiantit, ku kryhet riciklimi/asgjësimi etj.;

b) emrin e investitorit;

c) kapacitetin e impiantit;

d) zonën kadastrale dhe vendndodhjen e saj;

e) llojin e mbetjeve që trajtohen;

f) datën e pritshme të realizimit;

g) buxhetin dhe burime të tjera financiare dhe ekonomike;

h) vlerësimin strategjik mjedisor;

i) vlerësimi i komenteve nga publiku dhe grupet e interesit.

Objektivat, qëllimet, masat që do të merren dhe treguesit e suksesit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Objektivat	Qëllimet	Masat	Treguesit e suksesit

Masat, përgjegjësitë, afatet dhe buxhetet paraqiten në formatin e mëposhtëm:

Objektivat					
Nr.	Masat	Institucionet/ personat përgjegjës	Afati	Vitet	Buxheti i nevojshem

9. Pikat e forta dhe të dobëta të situatës aktuale të administrimit të mbetjeve, legjislacioni, institucionet, procedurat, ekonomia, të cilat do të përmbliidhen në tabelën e mëposhtme:

Aspektet	Pikat e forta dhe të dobëta	Arsyet për pikat e forta dhe të dobëta	Pasojat

10. Seksioni financiar mbulon minimalisht sa më poshtë:

- a) Pasojat ekonomike të çdo mase të parashikuar;
- b) investimet e parashikuara për administrimin e mbetjeve;
- c) kostot administrative të parashikuara për administrimin e mbetjeve;
- d) burimet e propozuara të financimit, përfshirë çmimet, taksat, tarifat dhe të ardhurat prej tyre, subvencione të mundshme etj.

11. Rezultatet e monitorimit të zbatimit të planit përmbliidhen në formatin e mëposhtëm:

Treguesit	Rëndësia	Burimet e informacionit	Frekuenca e monitorimit

12. Të tjera:

- a) Vlerësimi i komenteve të paraqitura nga publiku;
- b) dokumente të vlerësimit strategjik mjedisor.

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr.6, datë 9.10.2007

PËR MBLEDHJEN DHE RUAJTJEN E TË DHËNAVE PËR CILËSINË E BENZINËS DHE TË DIEZELIT

Në zbatim të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.147, datë 21.3.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel”, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës,

UDHËZOJNË:

1. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimtarinë nëpërmjet strukturave të specializuara të tyre për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel, sipas standardeve dhe afateve kohore të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.147, datë 21.3.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel”.

2. Inspektorati Qendror Teknik, merr dhe sistemon të dhënat nga prodhuesit vendas, nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe tregtuesit me shumicë dhe pakicë në lidhje me cilësinë dhe sasinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel për shkallën e përputhshmërisë për secilin parametër. Një kopje e këtyre të dhënave dërgohet pranë Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve çdo 6 muaj që nga dita e hyrje në fuqi të këtij udhëzimi.

3. Strukturat lokale të Inspektoratit Qendror Teknik organizojnë në bashkëpunim me Agjencitë Rajonale të Mjedisit programe pune të përbashkëta për marrjen e mostrave për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel.

4. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës organizojnë 2 herë në vit takime të përbashkëta të strukturave të tyre të

ngarkuara për zbatimin e këtij udhëzimi për shkëmbimin e informacionit mbi ecurinë e zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.147, datë 21.3.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diezel”.

5. Të dhënat e grumbulluara, për parametrat e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel, analizohen nga Inspektorati Qendror Teknik dhe janë objekt i diskutimit në takimet e përbashkëta ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave sipas pikës 4 të këtij udhëzimi.

6. Rafineritë dhe shoqëritë e tregtimit me shumicë dërgojnë pranë Inspektoratit Qendror Teknik, çdo tre muaj, informacion në lidhje me sasinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel të hedhura në tregun e brendshëm.

7. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve ruan dhe administron informacionin e marrë nga Inspektorati Qendror Teknik dhe krijon *database* të të dhënave në lidhje me cilësinë e benzinës dhe diezELIT. Një kopje e informacionit publikohet në faqen elektronike të Ministrisë së Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Ngarkohen Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve dhe Inspektorati Qendror Teknik për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Lufter Xhuveli

MINISTRI I EKONOMISË
TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Genc Ruli

UDHËZIM
Nr.8, datë 27.11.2007

PËR NIVELET KUFI TË ZHURMAVE NË MJEDISE TË CAKTUARA

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 2 të nenit 2 të ligjit nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”

UDHËZOJMË:

1. Nivelet kufi të zhurmës për mjedise të caktuara, të jenë sipas vlerave udhëzuese të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) të dhëna më poshtë në aneksin 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

2. Si mjedise të caktuara, për efekt të zbatimit të këtij udhëzimi, janë identifikuar mjediset e zonave të banimit, (jashtë banesës, mjediset e brendshme të banesës), institucionet (arsimore, parashkollore e shëndetësore), zona me aktivitet social-ekonomik, mjedise urbane dhe parqet publike.

3. Ekspertët e certifikuar që bëjnë matjet e zhurmës në mjediset e përmendura në pikën 2 të këtij udhëzimi, mbajnë parasysh shpjegimet që shoqërojnë aneksin 1.

4. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Lufter Xhuveli

MINISTRI I SHËNDETËSISË
Nard Ndoka

ANEKSI 1
NIVELET KUFI TË ZHURMËS PËR MJEDISE TË CAKTUARA

Mjedisi	Efekt i kritik në shëndet	LA _{eq} (dBA)	Koha bazë (orë)	L _{max} Fast (dB)
Zona banimi				
Jashtë banese	Bezdi (shqetësim) serioze gjatë ditës dhe mbrëmjes	55	16	-
	Bezdi (shqetësim) i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	50	16	-
Në brendësi të banesave	Kuptueshmëri e bisedës dhe (bezdi) shqetësim i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	35	16	-
Në brendësi të dhomës së fjetjes	Prishja e gjumit natën	30	8	-
Jashtë dhomës së fjetjes	Prishje e gjumit, dritare e hapur (vlera nga jashtë)	45	8	-
Institucione				
Klasa mësimi, institucione-mjedise parashkollore (brenda)	Kuptueshmëri e bisedës, vështirësi në kuptimin e informacionit, komunikimin e mesazhit	35	Gjatë mësimi	-
Dhomat e fjetjes në kopshte (brenda)	Prishje e gjumit	30	Koha e gjumit	-
Oborri i shkollës, vendet e lojrave në shkollë	Bezdi (shqetësim) - (burime të jashtëme)	55	Koha e pushimit	-
Spitale, salla, dhoma (brenda)	Prishja e gjumit natën Prishja e gjumit ditën dhe në mbrëmje	30	8	40
		30	16	
Spitale, salla trajtimi (brenda)	Ndikim në pushim, çlodhje	# 1		
Zona me aktivitetet social-ekonomik				
Zona industriale, tregtare, qarkullimi trafiku (mjedis i jashtëm dhe i brendshëm)	Dëmtim dëgjimi	70	24	110
Mjedis urban				
Mjedise publike, të jashtme apo të brendshme	Dëmtim dëgjimi	85	1	110
Ceremoni, festivale dhe argëtime	Dëmtim dëgjimi (klientët < 5 herë/ vit)	100	4	110
Muzikë nëpërmjet kufjeve të dëgjimit	Dëmtim dëgjimi	85 # 4	1	110
Tinguj - zhurme impulsive nga fishekzjarret dhe armët e zjarrit	Dëmtim dëgjimi (të rriturit)	-	-	140#2
	Dëmtim dëgjimit (fëmijët)			120#2
Parqe publike				
Parqet natyrore dhe zonat e mbrojtura	Prishje e qetësisë	#3		

Shpjegime:

- LAeq (dBA) = Niveli ekuivalent i matur në shkallën A.
Koha bazë (orë) = Koha gjatë së cilës bëhet matja.
LAmax Fast (dB) = Niveli i matur në shkallën A në mënyrën *fast* (e shpejtë)
1 = Sa më e ulët që të jetë e mundur.
2 = Presioni zanor maksimal (LAmax, fast) matur 100 mm larg veshit.
3 = Zonat e jashtme të qeta duhet të mbrohen dhe raporti i zhurmës hyrëse/shtesë me zhurmën e fonit natyral duhet të ruhet sa më i ulët që të jetë e mundur.
4 = Nën kufjet e dëgjimit, përshtatur me vlerat e fushës së lirë.

RREGULLORE
Nr.1, datë 30.3.2007

**PËR TRAJTIMIN E MBETJEVE TË NDËRTIMIT NGA KRIJIMI, TRANSPORTIMI E
DERI TEK ASGJËSIMI I TYRE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 12 të ligjit nr. 9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, miratojnë rregulloren si më poshtë:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore synon të disiplinojë procesin e administrimit të mbetjeve të fushës së ndërtimit, duke vendosur rregulla e kërkesa konkrete për të gjitha subjektet që operojnë në sferën e ndërtimit e të trajtimit të mbetjeve që gjenerohen prej tij.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet në:

- a) miratimin dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit, rikonstruksionit apo të prishjes së ndërtesave;
- b) miratimin dhe ngritjen e impianteve dhe zonave për depozitim të përkohshëm të mbetjeve të ndërtimit;
- c) trajtimin dhe transportin e mbetjeve të ndërtimit;
- d) funksionimin e impianteve dhe zonave për asgjësimin e mbetjeve të ndërtimit.

Neni 3
Përkufizime

Termet e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“mbetje ndërtimi” përfshin mbetjet e renditura në kapitullin 17 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”.

“prodhues mbetjesh”, “zotërues mbetjesh”, “leje” dhe “administrim i mbetjeve” kanë kuptimin e përcaktuar në ligjin nr.9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, në ligjin nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe në ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”.

Neni 4
Mbetjet e lejuara

Personi fizik apo juridik, aktiviteti i të cilit prodhon, zotëron, transporton dhe administron mbetje ndërtimi apo kryen përpunimin paraprak, përzierje apo procese të tjera që ndryshojnë natyrën ose përbërjen e këtyre mbetjeve, është i detyruar t'i ruajë, depozitojë, transportojë dhe dorëzojë ato në mënyrë të veçantë për rikuperim, në rastet kur llojet e mbetjeve të mëposhtme prodhohen veçmas gjatë aktivitetit të tyre:

- a) Qelqe (katalogu për klasifikimin e mbetjeve: 17 02 02 Qelqe)
- b) Plastikë (katalogu për klasifikimin e mbetjeve: 17 02 03 Plastike)
- c) Metale, duke përfshirë edhe aliazhet e tyre (katalogu për klasifikimin e mbetjeve nr. 17 04 01 deri te 17 04 07 dhe 17 04 11):

- 17 04 01 bakër, bronx, tunxh
- 17 04 02 alumin
- 17 04 03 plumb
- 17 04 04 zink
- 17 04 05 hekur dhe çelik
- 17 04 06 kallaj
- 17 04 07 metale të përziera
- 17 04 11 kablo, të tjera nga ato të përmendura në 17 04 10

- d) Beton, tulla dhe përzierje të tjegullave dhe qeramikës, duke përjashtuar ato që përmbajnë substanca të rrezikshme:

- 17 01 01 beton
- 17 01 02 tulla
- 17 01 03 tjegulla dhe qeramika
- 17 01 07 përzierje te betonit, tullave, tjegullave dhe qeramikës, të tjera nga ato të përmendura në 17 01 06

- e) materiale për punimet në rrugë
- f) materiale të strukturave ndërtimore
- g) pjesë ndërtimore të riaftësuar dhe
- h) mbetje të tjera nga pastrimi i kantierëve

- 17 09 04 mbetje të përziera nga ndërtimi dhe të prishjeve, të tjera nga ato të përmendura në 17 09 01, 17 09 02 dhe 17 09 03.

Neni 5
Mbetjet e ndaluara

1. Mbetjet e ndërtimit si më poshtë nuk pranohen për asgjësim përfundimtar në një impiant, i cili funksionon në përputhje me këtë rregullore:

- 17 01 06* përzierje ose fraksione të ndara betoni, tullash, tjegullash dhe qeramikës që përmbajnë substancë të rrezikshme
- 17 02 04* dru, qelq dhe plastika që përmbajnë apo janë të ndotura me substanca të rrezikshme
- 17 03 përzierje bituminoze, bitumi dhe produkte të tjera të ziftit;
- 17 03 01* përzierje bituminoze që përmbajnë zift qymyri
- 17 03 03* zift qymyri dhe katran;
- 17 04 09* mbetje metalore të kontaminuara me substanca të rrezikshme;
- 17 04 10* kablo që përmbajnë naftë, bitum apo substanca të tjera të rrezikshme
- 17 05 03* dhera dhe gurë që përmbajnë substancë të rrezikshme
- 17 05 05* balta që përmbajnë lëndë të rrezikshme'
- 17 05 07* çakëll që përmban substanca të rrezikshme

17 06	materiale izoluese dhe materiale ndërtimi me azbest
17 06 01*	material izolimi që përmban azbest
17 06 03*	materiale izolimi që konsistojnë ose përmbajnë substanca të rrezikshme
17 06 05*	materiale ndërtimi që përmbajnë azbest
17 08*	materiale ndërtimi me gips
17 08 01*	materiale ndërtimi me gips që janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme
17 09	mbetje të tjera ndërtimi dhe të prishjeve
17 09 01*	mbetje ndërtimi dhe të prishjeve që përmbajnë mërkur
17 09 02*	mbetje ndërtimi dhe të prishjeve që përmbajnë PCB (p.sh. izolues që përmbajnë PCB, parkete me bazë rrëshire që përmbajnë PCB, pjesë glazure të izoluar që përmbajnë PCB, kondensatorë që përmbajnë PCB)
17 09 03*	mbetje nga ndërtimi /prishjet (duke përfshirë mbetjet e përziera) që përmbajnë substanca të rrezikshme.

2. Personat fizikë dhe juridikë, para shembjes ose shkatërrimit të strukturave ndërtimore, largojnë materialet e mbetjet e rrezikshme, në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 9537, datë 18.5.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”.

KREU II VEÇIMI I MBETJEVE

Neni 6 **Detyrimet e zotëruesit të mbetjeve**

1. Operatorët lejohen t’i grumbullojnë të pandara mbetjet e renditura në nenin 4, vetëm nëse më pas dorëzohen në një impiant ku ato ndahen dhe rikuperohen në të njëjtën sasi si të ishin ndarë dhe rikuperuar në vendin e prodhimit të tyre.

2. Mbetjet e pandara dorëzohen në një impiant që është i pajisur me një leje të vlefshme për t’i marrë këto mbetje.

3. Për pasqyrimin e prodhimit, transportimit dhe asgjësimit të mbetjeve të ndërtimit mbahen regjistra.

Neni 7 **Miratimi paraprak**

1. Brenda 30 ditëve nga përfundimi i projektit/aktivitetit të shembjes dhe brenda 30 ditëve nga përfundimi i projektit të ndërtimit, personi fizik ose juridik, të cilit i është lëshuar leja për projektin, paraqet pranë pushtetit vendor dokumentet e nevojshme që provojnë përmbushjen e kërkesave të kësaj rregulloreje, para kontrollit përfundimtar.

2. Në rast se një projekt përfshin edhe shembjen edhe ndërtimin, raporti dhe dokumentacioni për projektin e shembjes, paraqitet dhe miratohet nga pushteti vendor përpara lëshimit të lejes së ndërtimit për projektin.

Neni 8 **Venddepozitimi i përkohshëm**

1. Në planin vendor të administrimit të mbetjeve të ngurta, çdo komunë apo bashki përcakton një vend për përpunimin dhe depozitimin e përkohshëm të mbetjeve të ndërtimit.

2. Vendi për përpunimin dhe depozitimin e përkohshëm të mbetjeve të ndërtimit caktohet që të pranojë jo më tepër se 30 tonë në ditë ose 2 000 tonë në vit mbetje.

3. Mbetjet e ndërtimit nuk mund të depozitohen në një impiant të përkohshëm për më shumë se tre vjet.

Neni 9 **Impiantet**

Impiantet për përpunimin, depozitimin ose riciklimin e mbetjeve të ndërtimit, plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) të jenë me sipërfaqe të rrafshët;
- b) të jenë të pajisur me një sistem sipërfaqësor të përshtatshëm për grumbullimin e kullimin e ujit, për të parandaluar ndotjen e ujërave sipërfaqësore e nëntokësore;
- c) të kenë të përcaktuar një zonë ku depozitohen mbetjet e paseleksionuara.

Impianti duhet të ketë:

- a) peshore për regjistrimin e hyrjeve dhe daljeve të sasive të mbetjeve;
- b) konteniërë për depozitim të përkohshëm të mbetjeve që janë ndarë;
- c) sistem të përshtatshëm për parandalimin dhe reagimin ndaj zjarrit;
- d) pajisje higjieno-sanitare të përshtatshme për personat që ndodhen në terren;
- e) rrethim të zonës së punës me lartësi minimumi 2.0 m;
- f) tabelë informimi pranë hyrjes, e cila të përmbajë orarin e punës, emërtimin, adresën dhe numrin e telefonit të pronarit dhe të administratorit të impiantit;
- g) veshje pune të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të gjithë stafin, duke përfshirë veshje mbrojtëse, çizme me majë çeliku, mbrojtëse për sytë dhe veshët;
- h) kabinë për pajisjet e personelit, si p.sh. veshjet e punës, çizmet mbrojtëse, mbrojtëset për veshët dhe sytë;
- i) depozitë të përkohshme të identifikuar për mbetjet urbane;
- j) personel gjatë orëve të punës;
- k) pajisje të përshtatshme për dhënien e ndihmës së shpejtë;
- l) pajisje për ndërhyrje emergjence;
- m) materiale që kufizojnë përhapjen e vajrave (tallash etj.);
- n) fikës zjarri dore të cilët kanë numër kontrolli të vlefshëm.

Neni 10 **Garancia financiare**

1. Përpara lëshimit të lejes së ndërtimit ose të shembjes për një strukturë që prodhon mbetje ndërtimi, të cilat duhet të depozitohen në një venddepozitim kërkuesi duhet të depozitojë një shumë në para pranë pushtetit vendor në sasinë që do të përcaktohet nga këshilli i qeverisjes vendore për çdo ton mbetje të parashikuar nga ndërtimi dhe/ose shembja/prishja, e cila nuk do të jetë më e vogël se 5% e vlerës së strukturës.

2. Pasi të provohet se mbetjet e ndërtimit ose ato të shembjes janë dorëzuar sipas rregullit në një impiant venddepozitimi të mbetjeve, i cili është i pajisur me leje të vlefshme për t'i pritur ato, depozita monetare i kthehet kërkuesit pa interes. Depozita konfiskohet në rast se nuk përmbushen kërkesat e mësipërme.

Neni 11 **Transportimi**

1. Transportimi i mbetjeve të ndërtimit, materialeve dhe pajisjeve për në dhe nga impianti kryhet në mënyrën më të sigurtë dhe me shqetësim sa më të vogël për personat që ndodhen në

impiant dhe përgjatë rrugëve të cilat të çojnë atje.

2. Mjetet që përdoren për transportim mbetjesh ose materialesh për në ose nga impianti pastrohen përpara largimit nga impianti.

3. Mbetjet dhe materialet në mjetet e transportit që hyjnë apo dalin nga një impiant, mbulohen dhe mbliidhen në mënyrë të tillë që të mos derdhen ose ndotin gjatë transportimit.

Neni 12

Mirëmbajtja e impiantit

1. Impianti mirëmbahet në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

a) Impianti dhe rrugët hyrëse pastrohen rregullisht dhe mbahen pastër nga mbetjet, pluhuri, dheu dhe bora;

b) materiali i përdorur për përpunimin e mbetjeve, mirëmbahet në përputhje me udhëzimet e furnizuesit dhe zëvendësohet menjëherë në rast se nuk kryen më funksionet përkatëse;

c) të gjitha pjesët e impiantit duke përfshirë kufijtë, kanalet, pusët mbledhëse, rezervuarët, ndarëset e vajit, gardhet, bimësinë dhe rrugët e brendshme, mirëmbahen rregullisht.

2. Punëmarrësit trajnohen mbi procedurat e reagimit në raste emergjence, në veçanti për rastet e rënies së zjarrit, rrjedhjeve të tretësirës së mbetjeve në tokë ose në ujërat sipërfaqësore.

3. Pronari i impiantit ku mbërrijnë mbetje ndërtimi në një sasi më të madhe se 30 tonë në ditë ose 2 000 tonë në vit, vendos dhe mirëmban një sistem informacioni, standarde dhe kërkesa në punë, për të siguruar që impianti plotëson kushtet e renditura në lejen mjedisore.

4. Manuali i proceseve të punës përmban informacionet e mëposhtme:

a) emrin dhe adresën e pronarit dhe operatorit;

b) adresa dhe numra telefonash të rëndësishëm për sigurinë dhe mirëfunksionimin e impiantit;

c) përshkrimin e masave për depozitimin dhe përpunimin e mbetjeve dhe për sistemet, për mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit;

d) makineritë e përhershme dhe të përkohshme në impiant;

e) kriteret për pranimin e mbetjeve;

f) procedurat për mospranimin e mbetjeve, të cilat impianti nuk është i autorizuar t'i pranojë;

g) përshkrimi i proceseve të punës së aktiviteteve të lejuara në impiant.

Ky përshkrim duhet të përmbajë të paktën informacionet e mëposhtme:

i) aktivitetet e depozitimit;

ii) aktivitetet e përpunimit, duke përfshirë metodat dhe materialet e përdorura;

iii) procedurat e reagimit, kur ka emergjenca për shkak të zjarrit, ndotjes prej rrjedhjes së tretësirës së mbetjeve, aksidentet në punë dhe nga ndalimi i punës;

iv) procedurat për kontrollin e faktorëve dëmtes, duke përfshirë pluhurin, aromat dhe insektet e dëmshme;

v) procedurat e inspektimit dhe monitorimit në përputhje me kushtet e renditura në leje;

vi) standardet për përzgjedhjen e kampioneve gjatë procedurave të monitorimit;

vii) standardet dhe kërkesat për raportimin e rezultateve të procedurës së monitorimit.

KREU III

LEJA

Neni 13

Lëshimi i lejes mjedisore

1. Miratimi i lejes së sheshit dhe lejes së ndërtimit të venddepozitimit apo impiantit të trajtimit të mbetjeve të ndërtimit bëhet sipas dispozitave të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", i ndryshuar.

2. Leja mjedisore per venddepozitimin apo impiantin e trajtimit të mbetjeve të ndërtimit bëhet sipas dispozitave të ligjit nr.8990, datë 23.1.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

3. Leja për ngritjen e një impianti depozitimi, trajtimi apo asgjesimi për mbetjet e ndërtimit, nuk do të lëshohet derisa kërkuesi të ketë ofruar një garanci të përshtatshme financiare dhe të provojë:

a) ekspertizë dhe eksperiencë të përshtatshme, ose mundësi për të përdorur këtë ekspertizë dhe eksperiencë, gjatë funksionimit të një venddepozitimi;

b) disponueshmerinë e burimeve financiare të përshtatshme për të administruar venddepozitimin në përputhje me lejen;

c) të drejtën ligjore për të përdorur ose për të zënë token në të cilën ndodhet venddepozitimi i mbetjeve të ndërtimit; dhe

d) përmbushjen e kërkesave të legjislacionit shqiptar.

4. Kërkesa për leje venddepozitimi apo impiant trajtimi do të refuzohet në rast se:

a) është vendosur në një zonë të mbrojtur, arkeologjike, turistike apo në çdo zonë që mbrohet me një akt normativ;

b) është vendosur brenda 300 metrave nga një pus furnizues me ujë;

c) është vendosur brenda 70 metrave nga një përrua, liqen ose kompleks ligatinor;

e) është vendosur brenda 300 metrave nga një zonë e mbrojtur në përputhje me pikën (a) më sipër;

f) zona e impiantit të ri ku do të vendosen mbetjet e ndërtimit nuk do të ketë një shtresë të përbërë nga më pak se 50 cm argjilë të ngjeshur dhe impianti i ri nuk do të instalohet dhe mbajë në funksionim një sistem monitorimi të ujërave nëntokësore dhe sistem rregullues të tretësirës së mbetjeve;

g) në vendin e ndërtimit nuk mund të depozitohen më shumë se 2 000 tonë material.

Neni 14

Përmbajtja e lejes

1. Operatori depoziton apo trajton mbetjet e ndërtimit në përputhje me kushtet dhe kërkesat e vendosura në lejen mjedisore.

2. Leja mjedisore për impiantin apo venddepozitimin e mbetjeve të ndërtimit përmban kushte për:

a) fazën e ndërtimit;

b) fazën operacionale;

c) monitorimin periodik të indikatorëve të mjedisit, raportimin dhe publikimin e tyre;

d) regjistrimin e mbetjeve dhe raportimin e tyre;

e) kohëzgjatjen e lejes mjedisore.

f) monitorimin dhe rehabilitimin e vendit pas mbylljes së impiantit apo venddepozitimit;

KREU IV

MONITORIMI DHE KONTROLLI

Neni 15

Vetëmonitorimi

1. Operatori i impiantit kontrollon dhe mirëmban periodikisht:

a) ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve për mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit;

b) sistemet e kullimit, drenazhimit, trajtimit dhe shkarkimit të ujërave teknologjike dhe sipërfaqësore;

c) sistemin dhe masat për të kufizuar ndikimin e pluhurit dhe zhurmës.

2. Operatori i impiantit kryen periodikisht monitorimet e mëposhtme:
 - d) shkarkimet ne ajër, në ujë dhe tokë;
 - e) gjendjen e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore,
 - f) zhurmat, erëra, insekte të dëmshme dhe parametra të tjerë.
3. Operatori i impiantit siguron zbatimin e procedurave për pranimin dhe refuzimin e mbetjeve për depozitim, përpunim ose asgjësim.

Neni 16

Regjistrat

1. Operatori siguron që të gjitha materialet që hyjnë dhe dalin nga impianti të kontrollohen e regjistrohen, dhe mban regjistra me informacionin e mëposhtëm:
 - b) specifikime për volumin dhe përbërjen e materialeve që hynë në impiant nga çdo makinë;
 - c) emërtimin e personit, aktiviteti i të cilit ka prodhuar mbetjet;
 - d) furnizuesi;
 - e) data e dorëzimit/ nisjes së materialeve;
 - f) targa e mjetit;
 - g) emri i personit që ka inspektuar mbetjet.
2. Mbetjet që nuk pranohen nga punonjësi i impiantit, regjistrohen me të njëjtat detaje si në paragrafin 1. Regjistrimi përmban emrin dhe adresën e venddepozitimit tjetër, ku dërgohen këto mbetje.
3. Regjistri i mbetjeve dhe materialeve, të cilat dalin nga impianti për qëllim përdorimi, përfshin informacionin e mëposhtëm:
 - a) emrin dhe adresën e subjektit ku do të përdoren materialet, si dhe lloji i materialit;
 - b) çdo lloj pagese apo tarife e kryer për materialin.

Neni 17

Raportimi dhe informimi

1. Pronari i impiantit i dorëzon inspektoratit të mjedisit dhe pushtetit vendor një raport vjetor, i cili përmban rezultatet e monitorimit të:
 - a) sasive dhe përmbajtjeve të mbetjeve të pranuar në impiant dhe të testuara në bazë të kriterëve të pranimit;
 - b) cilësisë dhe sasisë së tretësirës së mbetjeve dhe/ose ujërave sipërfaqësore nga impianti dhe vendi i asgjësimit përfundimtar të tretësirës së mbetjeve;
 - c) monitorimit të ujërave nëntokësore, nëse ka të tilla,
 - d) monitorimit të ujërave sipërfaqësore pritëse, nëse ka të tilla;
 - e) matje apo llogaritje të zhurmës;
 - f) monitorimit të pluhurave, nëse ka të tillë;
 - g) emergjencave gjatë së cilës janë ndjekur procedurat e emergjencës.
2. Organi i kontrollit informohet menjëherë, nëse gjatë funksionimit ose monitorimit të impiantit është vënë re ndonjë parregullsi që mund të ketë pasoja negative në shëndet e në mjedis.
3. Nëse operatorit të venddepozitimit i është kërkuar të instalojë puse monitorimi të ujërave nëntokësore dhe të monitorojë cilësinë e ujërave nëntokësore nën vendin e depozitimit, operatori mirëmban pusët vëzhguese të ujërave nëntokësore dhe monitoron cilësinë e ujërave tokësore për dhjetë vjet pas mbylljes së venddepozitimit.
4. Operatori siguron, gjithashtu, garanci financiare për mirëmbajtjen e vazhdueshme të puseve monitoruese të ujërave nëntokësore dhe për të monitoruar cilësinë e ujërave nëntokësore për dhjetë vjet pas mbylljes së venddepozitimit.
5. Pronari i impiantit përgatit dhe përditëson për furnizuesit e mbetjeve një udhëzues me shkrim, i cili shpjegon kriteret dhe procedurat për pranimin apo refuzimin e mbetjeve në impiant.

Neni 18
Kontrolli

Organet e qeverisjes vendore, inspektorati i mjedisit dhe policia e ndërtimit ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm mbi gjeneruesit e mbetjeve të ndërtimit, venddepozitimet dhe impiantet e trajtimit të tyre.

Neni 19
Sanksionet

Shkelësit e kërkesave të kësaj rregulloreje, ndëshkohen me sanksione sipas specifikimeve të bëra në legjislacionin mjedisor dhe konkretisht në zbatim të neneve 32-33 të ligjit nr. 9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”.

Neni 20
Zbatimi

1. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe organet e qeverisjes vendore, ngarkohen për zbatimin e kësaj rregulloreje.

2. Zbatimi i kësaj rregulloreje është i detyrueshëm për të gjithë personat fizikë dhe juridikë që prodhojnë, zotërojnë, depozitojnë, trajtojnë apo asgjësojnë mbetje ndërtimi.

Neni 21
Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.
2. Neni 4, do të zbatohet pas hyrjes në fuqi të rregullores së përpunimit dhe asgjësimit të mbetjeve urbane.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Lufter Xhuveli

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE
TELEKOMUNIKACIONIT
Lulzim Basha

RREGULLORE
Nr.6, datë 30.11. 2007

PËR ADMINISTRIMIN E MBETJEVE SPITALORE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr. 9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” dhe pikës 1 të nenit 27 të ligjit nr. 9537, datë 18.5.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme” Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministri i Shëndetësisë miratojnë rregulloren si më poshtë:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i rregullores

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave për kontrollin e prodhimit, grumbullimit, transportimit, magazinimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore për të siguruar mbrojtjen e shëndetit publik dhe të mjedisit.

2. Përkufizime të termave

Në kuptimin e kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “mbetje spitalore” janë mbetjet e përcaktuara sipas kuptimit të pikës 6 të nenit 2 të ligjit 9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, ku përfshihen mbetjet e rrezikshme dhe jo të rrezikshme, të cilat renditen në paragrafin 18 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.99, datë 19.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar për klasifikimin e mbetjeve”;

b) "prodhues i mbetjes" është personi fizik dhe juridik, sipas kuptimit të pikës 11 të nenit 2 të ligjit nr.9010, datë 13.2.2003 “Për Administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, i cili zotëron ose administron një njësi, e cila krijon mbetje spitalore, duke përfshirë dhe duke mos u kufizuar vetëm në: spitalet e përgjithshme, infermieritë ose spitalet e riaftësisimit, qendrat mjekësore para spitalore, klinikat e dializës kronike, klinikat e hapura, subjektet e mirëmbajtjes shëndetësore, klinikat kirurgjikale, spitalet e psikiatrisë akute, laboratorët, ndërtesat spitalore, klinikat mjekësore humane dhe veterinare, depot farmaceutike, farmacitë, si dhe klinikat dentare. Në rast se më shumë se një prodhues është vendosur në të njëjtën ndërtesë, secili prej tyre do të konsiderohet si një prodhues i veçantë;

c) “prodhues të vegjël” janë qendrat shëndetësore që prodhojnë mbetje spitalore jo më shumë se mbetjet spitalore të dhjetë shtretërve spitalorë, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në: klinikat mjekësore, klinikat dentare, kiro-praktikuesit, laboratorët e vegjël spitalorë, qendrat e vaksinimit; qendrat e specializuara shëndetësore, të cilat krijojnë sasi të vogla mbetjesh (infermieritë, spitalet psikiatrike, qendrat për personat me aftësi të kufizuara); aktivitetet joshëndetësore ku përfshihen ndërhyrjet ndërvenoze dhe nënlëkurë (subkutane), (qendrat kozmetike, të tatuazhit dhe ato për rehabilitimin nga droga), shërbimet funerale, shërbimet ambulatorë dhe të infermierisë, të cilat vizitojnë pacientë në banesat e tyre;

d) “zotërues i mbetjes spitalore” është personi fizik e juridik, sipas kuptimit të pikës 13 të nenit 2 të ligjit nr.9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, i cili: krijon mbetje spitalore; grumbullon, ruan përkohësisht, transporton dhe largon për në vendin e caktuar mbetjet spitalore të prodhuara prej tij, si dhe i përpunon dhe i asgjëson ato;

e) “transport” është aktiviteti që lidhet me transportin e mbetjeve spitalore, duke përfshirë ngarkimin, transportimin e shkarkimin, sikurse dhe përgatitja, shërbimi e mirëmbajta e pajisjeve të përdorura për transportin e mbetjeve spitalore;

f) “qendër shëndetësore” është çdo vend ku mbetjet spitalore prodhohen, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar te: spitalet, qendrat kirurgjikale ambulatorë, qendrat e urgjencës shëndetësore, klinikat dhe njësitë ambulatorë të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë klinikat e mjekëve dhe dentistëve, laboratorët e diagnostikimit shëndetësor, bankat e gjakut, depot farmaceutike, laboratorët kërkimorë, agjencitë shëndetësore, klinikat dietologjike ose të kujdesit shëndetësorë, veterinaritë dhe spitalet, dyqanet e kafshëve shtëpiake, qendrat që ushtrojnë shërbimet e pastrimit të mbetjeve njerëzore në vendet e aksidenteve dhe morgët;

g) “instrumente të mprehta” janë të gjitha sendet e infektuara apo të painfektuara, që mund të shkaktojnë shpime apo prerje, duke përfshirë dhe mos u kufizuar vetëm tek aget, shiringat, bisturitë, tubat kapilarë dhe instrumentet e tjera të mprehta;

h) “mbetje infektuese” janë të gjitha mbeturinat e ndotura nga çdo lloj patogjeni si bakteriet, viruset, parazitët ose kërpudhat dhe përfshijnë kulturat nga puna në laboratorë, mbeturinat nga ndërhyrjet kirurgjikale dhe autopsitë, mbeturinat nga pacientët e infektuar, si dhe materialet apo pajisjet (që janë për t’u hedhur) në kontakt me këta pacientë, me kafshë të infektuara, si dhe materialet dhe pajisjet e mjekëve dhe të personelit tjetër, që kanë qenë në kontakt me pacientë të infektuar;

i) “mbetje patologjike” përfshijnë indet, organet, pjesë të trupit, placentat, gjakun dhe lëngjet e tjera të organizmit të njeriut;

j) “mbetje farmaceutike” përfshijnë produktet farmaceutike të skaduara ose të papërdorshme, produktet farmaceutike të kontaminuara nga rënia/ rrëzimi përtokë, barnat e tepërta, vaksinat ose serumet dhe sendet e hedhura të përdorura gjatë trajtimit të barnave të tilla si shishe, kuti, doreza, maska, tuba ose shishe;

k) “mbetje radioaktive” përfshijnë mbeturinat e lëngëta, të ngurta dhe të gazta, të ndotura me lëndë radioaktive, të prodhuara nga analizat “*in vitro*” të indeve dhe lëngjeve të trupit, si dhe nga imazheria “*in vivo*” e organeve të ndryshme për qëllime diagnostike dhe terapeutike;

l) “mbetje e rrezikshme” përfshijnë mbeturinat e infektuara, patologjike, shpuese, farmaceutike, toksike, kimike dhe radioaktive, ujin dhe tretës të infektuar;

m) “mbetje të parrezikshme” përfshijnë letrat, sendet prej qelqi, plastike, kartonët, ambalazhet, mbeturinat ushqimore, mbeturina druri dhe ndërtimi;

n) “administrimi i mbetjeve” përfshin minimizimin, ndarjen, grumbullimin, transportimin, depozitimin, asgjësimin, pakësimin dhe ripërdorimin e mbetjeve;

o) “magazinim” është grumbullimi i përkohshëm në një vend të caktuar të mbetjeve spitalore për një kohë jo më shumë se një vit, sipas kërkesave të paragrafit 7.5 të kësaj rregulloreje.

3.Zbatimi

Kjo rregullore zbatohet nga çdo prodhues, zotërues, magazinues, trajtues ose asgjësues i mbetjeve spitalore.

Përjashtohen nga zbatimi i kësaj rregulloreje:

a) Individët prodhues të mbetjeve spitalore, kur këto prodhohen gjatë vetëmjekimit ose gjatë shërbimit mjekësor në banesë, përveçse kur individit detyrohet t’i vendosë mjetet e mprehta në kontenerë rezistentë ndaj shpimeve dhe t’i largojë ato në përputhje me rregullat e miratuara nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MPAU) dhe Ministri i Shëndetësisë;

b) Prodhuesit e vegjël, të cilët prodhojnë sasi të vogël mbetjesh spitalore që nuk i kalon mbetjet spitalore të prodhuara nga dhjetë shtretër spitalorë;

c) Shërbimet ambulatore ose të urgjencës.

KREU II

DETYRIMET E PRODHUESVE TË MBETJEVE SPITALORE

4. Prodhuesit e mbetjeve spitalore janë përgjegjës për:

a) grumbullimin me kujdes dhe të kontrolluar të mbetjeve spitalore pranë qendrës shëndetësore;

b) ndarjen e mbetjeve spitalore të parrezikshme (të llojit urban) nga mbetjet spitalore të rrezikshme;

c) ambalazhimin, etiketimin, magazinimin, grumbullimin, administrimin, trajtimin, transportimin dhe asgjësimin në mënyrë të përshtatshme të mbetjeve spitalore të gjeneruara prej tyre;

d) shpenzimet e transportit, asgjësimit ose riciklimit të mbetjeve spitalore të gjeneruara prej tyre. Kjo përgjegjësi është e pashmangshme dhe e pavarur nga përgjegjësia e ndonjë personi të tretë të ngarkuar nga prodhuesi për të ndërmarrë këto aktivitete;

e) të gjitha dëmet e shkaktuara në mënyrë direkte ose indirekte në mjedis dhe shëndetin publik nga procesi i grumbullimit, magazinimit, transportimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore të krijuara prej tyre.

5. Regjistrimi

5.1 Çdo prodhues i mbetjeve spitalore duhet të regjistrohet në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, ndërsa prodhuesit që fillojnë aktivitetin e tyre pas botimit të saj në Fletoren Zyrtare jo më vonë se 30 ditë para fillimit të aktivitetit që krijon mbetje spitalore.

5.2 Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave vendos një numër regjistrimi për çdo prodhues të mbetjeve spitalore, i cili i njoftohet prodhuesit.

5.3 Çdo prodhues duhet të vendosë numrin e regjistrimit mbi të gjitha fletët shoqëruese, etiketat e vendosura në ambalazhimet që mbajnë mbetje spitalore dhe skedat bashkëngjitur ngarkesave që përmbajnë mbetje spitalore.

5.4 Numri i regjistrimit është individual dhe nuk mund të transferohet.

5.5 Çdo prodhues duhet ta njoftojë me shkrim Ministrinë, brenda 30 ditëve, mbi ndryshimet në strukturën e pronësisë, emërtimin, vendndodhjen, mënyrën e veprimtarisë ose mbi ndonjë

ndryshim në aktivitetin e tij, që mund të ketë ndikim në llojin dhe sasinë e mbetjeve spitalore të krijuara.

6. Masat konkrete për administrimin e mbetjeve spitalore

Brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, çdo prodhues mbetjesh spitalore, përveç prodhuesve të vegjël, përgatit:

6.1 Një rregullore të brendshme për administrimin e mbetjeve spitalore brenda njësisë funksionuese.

6.2 Një plan për administrimin e mbetjeve spitalore, që duhet të përmbajë minimalisht informacionin e mëposhtëm:

a) një përshkrim të mbetjeve spitalore të prodhuara nga njësi përkatëse, duke përfshirë llojin, peshën dhe vëllimin;

b) një përshkrim të procedurave të kërkuara për administrimin e mbetjeve në njësinë përkatëse;

c) një përshkrim të zonës brenda dhe jashtë saj ku prodhohet, depozitohet apo trajtohet mbetja spitalore;

d) destinacionin, metodat e trajtimit dhe asgjësimit për çdo lloj mbetje spitalore;

e) procedurat dhe veprimtaritë për kualifikime në administrimin e mbetjeve spitalore;

f) veprimtaritë informative që lidhen me shëndetin, sigurinë dhe asgjësimin e rregullt të mbetjeve spitalore për të gjithë personat, që mund të bien në kontakt me to ;

g) procedurat dhe pajisjet e kontrollit të ndotjes dhe pastrimit;

h) emrin, adresën dhe numrin e telefonit të personit (personave) përgjegjës për administrimin e mbetjeve spitalore.

6.3 Çdo prodhues rishikon planin për administrimin e mbetjeve spitalore në përputhje me planin kombëtar për administrimin e mbetjeve të ngurta dhe planin kombëtar për administrimin e mbetjeve të rrezikshme, brenda një viti pas miratimit të tyre.

6.4 Plani për administrimin e mbetjeve spitalore duhet të përditësohet çdo tre vjet.

KREU III

TRAJTIMI I MBETJEVE SPITALORE

7. Çdo prodhues i mbetjeve spitalore është përgjegjës për trajtimin e mbetjeve që nga prodhimi, grumbullimi, ndarja, transporti, magazinimi, përpunimi dhe deri te asgjësimi i tyre.

7.1 Çdo prodhues ndan (seleksionon) që në burim elementët e rrezikshëm nga ata të parrezikshëm të mbetjeve spitalore, sipas rregullores së brendshme për administrimin e mbetjeve spitalore dhe i magazinon ato të ndara.

7.2 Në rast se në vendin e prodhimit apo gjatë transportit, mbetjet spitalore të rrezikshme, në mënyrë të vullnetshme apo të pavullnetshme përzihen me mbetje spitalore të parrezikshme, këto mbetje spitalore do të trajtohen si mbetje të rrezikshme.

7.3 Pas procesit të ndarjes, për mbetjet spitalore të parrezikshme që cilësohen si “mbetje urbane” nga paragrafi 9 i nenit 2 të ligjit nr.9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, zbatohet ligji nr.8094, datë 21.3.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”.

7.4 Mbetjet spitalore të rrezikshme ambalazhohen dhe etiketohen në përputhje me shtojcën 2.A dhe magazinohen të ndara nga mbetjet e tjera.

7.5 Kur mbetjet spitalore duhet të transportohen për t'u trajtuar në vend tjetër, magazinimi në terren i tyre bëhet në një zonë të caktuar në brendësi apo në afërsi të vendeve të trajtimit apo të pikave të nisjes duke përmbushur kërkesat e mëposhtme:

a) të lejohet hyrja vetëm e personave që kanë kualifikim për të administruar mbetje spitalore;

b) të tregohet kujdes për sigurinë e kontenierëve, të parandalohen rrjedhjet, të sigurohet mbrojtja nga uji, shiu dhe era, si dhe të shmangen kushtet e inkubimit mikrobik dhe/ose të dekompozimit të tyre. Mbetjet njerëzore, shtazore apo të ndonjë gjallesë tjetër të magazinuar për më shumë se 24 orë, por gjithsesi më pak se 48 orë nga ambalazhimi, duhet të ruhen në frigorifer ose hapësirë frigoriferike që përdoret vetëm për mbetjet spitalore në një temperaturë jo më të lartë

se 10° C;

c) të jenë ndërtuar me materiale të qëndrueshme që pastrohen lehtësisht, që nuk lejojnë depërtimin e lëngjeve dhe të jenë rezistentë ndaj parazitëve;

d) të mbahen pastër, në kushte të mira sanitare, dhe në gjendje të mirë funksionale;

e) mbetjet të jenë të etiketuara në mënyrë të dukshme me simbolin ndërkombëtar të bio-rrezikshmërisë të paraqitur në shtojcën 2.A dhe me njoftime të rrezikut në dyer, porta ose mbulesa, frigoriferë dhe konteinerë të tjerë që tregojnë përdorimin e magazinës për mbetje spitalore dhe se hyrja e personave të paautorizuar është e ndaluar;

f) sistemet e kullimit të dyshemesë së magazinës duhet t'i mundësojnë shkarkimet direkt në një sistem kanalizimesh sanitare për asgjësimin e ujërave të ndotura, në përputhje me ligjin nr. 9115, datë 24.7.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujrave të ndotura" ose në një impiant grumbullimi që parandalon derdhjen e lëngjeve dhe rënien në kontakt me mjedisin.

7.6 Konteinerët e mbetjeve të rrezikshme spitalore duhet të përmbushin kërkesat e përcaktuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, të etiketohen në përputhje me shtojcën 2.B dhe të magazinohen në mënyrë të tillë që të lejojnë hyrjen për qëllime inspektimi.

7.7 Mbetjet spitalore nuk duhet të presohen apo t'i nënshtrohen veprimeve të sforcuara mekanike, përveç rasteve kur këto janë pjesë e një procesi të posaçëm trajtimi të miratuar nga Ministri në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, bazuar në ligjin nr. 9537, datë 18.5.2006 "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme".

7.8 Çdo prodhues i vogël, transporton mbetjet e rrezikshme spitalore të prodhuara në një impiant për administrimin e tyre ose siguron transportin nga një punëmarrës i tij, vetëm kur plotëson kushtet e mëposhtme:

a) punëmarrësi që transporton mbetjet e rrezikshme spitalore duhet të jetë trajnuar për administrimin e këtyre mbetjeve;

b) mbetjet e rrezikshme spitalore transportohen brenda 45 ditëve nga grumbullimi i tyre.

7.9 Transportimi në terren i mbetjeve të rrezikshme spitalore kryhet në përputhje me planin për administrimin e mbetjeve spitalore;

a) mbetjet spitalore që krijohen jashtë zonës së prodhimit fillestar të tyre, nuk pranohen për transport në terren;

b) asnjë person nuk duhet të pranojë për transport mbetjet spitalore që nuk janë ambalazhuar dhe etiketuar në përputhje me shtojcën 2;

c) me përjashtim të prodhuesve të vegjël dhe përdoruesve të automjeteve të urgjencës siç janë autoambulancat, asnjë person nuk duhet të transportojë mbetje spitalore të rrezikshme pa lejen përkatëse, në përputhje me ligjin nr.9537, datë 18.5.2006 "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme";

d) prodhuesit e vegjël që transportojnë mbetjet spitalore të krijuara prej tyre nuk janë të detyruar të japin fletëdorëzimi në përputhje me paragrafin 7.14 të kësaj rregulloreje;

e) një automjet që transporton mbetje spitalore infektuese duhet të përmbushë kërkesat e shtojcës 4 të kësaj rregulloreje.

7.10 Impiantet për djegien e mbetjeve spitalore respektojnë kushtet e djegies dhe normat e shkarkimeve në ajër të përcaktuara në pikën 5.1.2 "Linja për djegien e mbetjeve të rrezikshme dhe spitalore" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë".

7.11 Inceneratorët që përdoren për trajtimin e mbetjeve spitalore, duhet të jenë të pajisur me siguresa ose pajisje të tjera kontrolli, për të parandaluar funksionimin e impiantit djegës, nëse nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuara në paragrafin e mësipërm 7.10. Në rast se arrihet një temperaturë më e ulët, impianti duhet të jetë i pajisur me djegësa ndihmës, të cilët duke mos llogaritur sasinë e nxehtësisë së mbetjeve, janë në gjendje të mbajnë në mënyrë të pavarur një temperaturë minimale prej 700° Celcius.

Përgjegjësi i inceneratorit :

a) kryen monitorime dhe regjistrime të vazhdueshme të dhomave primare dhe sekondare të djegies;

b) ruan të dhënat e monitorimeve të kryera për një periudhë shtatëvjeçare.

7.12 Të gjitha mbetjet spitalore që mund të digjen, duhet të shndërrohen nga inceneratori në hi, që nuk përkon me formën e mbetjeve para djegies. Ky hi që rezulton nga djegia, të paktën një herë çdo tre muaj, analizohet duke përdorur përzierje kampionaturash të rastit për përmbajtjen e karbonit organik total, dhe çdo vit analizohet për përmbajtjen e plumbit, mërkurit, kaliumit dhe metaleve të rënda. Hiri që rezulton nga djegia nuk duhet të ketë më shumë se 5% karbon (minimalisht 95% djegie).

7.13 Mbetja nga djegia ose hiri që përftohet nga procesi i trajtimit të mbetjeve spitalore është mbetje e ngurtë dhe asgjësohet në përputhje me nenin 21 të ligjit nr.9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”.

7.14 Impianti për trajtimin ose asgjësimin e mbetjeve spitalore nuk duhet të pranojë nga prodhuesit më shumë se 88 kilogramë/muaj mbetje spitalore infektuese ose çfarëdo sasive mbetjesh spitalore, në rast se nuk janë shoqëruar me fletëdorëzimi në përputhje me ligjin nr. 9537, datë 18.5.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”.

7.15 Në rast se një impiant trajton më pak se 20 kilogramë mbetje spitalore infektuese nga prodhuesi i vogël, impianti duhet të mbajë regjistrime të këtyre pranimeve që minimalisht përfshin informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin dhe adresën e prodhuesit;
- b) peshën e mbetjeve të pranuara;
- c) datën dhe orën e pranimit të mbetjeve; dhe
- d) nënshkrimin e personit që pranon mbetjet.

7.16 Të gjitha regjistrimet që bëhen sipas kësaj rregulloreje ruhen për një periudhë deri në shtatë vjet. Kjo periudhë shtyhet automatikisht në rast të mos zbatimit të aktit administrativ në lidhje me veprimtarinë e rregulluar, ose me kërkesën e Ministrit të Mjedisit.

7.17 Kërkesat e paragrafit 7.16 nuk zbatohen ndaj prodhuesve të vegjël dhe atyre prodhuesve të renditur në gërmat “a”, “b”, “c” të paragrafit 3 të kësaj rregulloreje.

KREU IV KONTROLLI DHE SANKSIONET

8. Kontrolli

a) Ndaj veprimtarisë së zotëruesve të mbetjeve spitalore ushtrojnë kontrole Inspektorati i Mjedisit, organi që ka licencuar veprimtarinë, Inspektorati Sanitar Shtetëror dhe inspektorati bashkiak.

b) Inspektorati Sanitar Shtetëror inspekton çdo spital, incinerator ose vendgrumbullimi të mbetjeve spitalore të krijuara nën juridiksionin e tij.

9. Sanksionet

Shkelësit e kërkesave të kësaj rregulloreje, ndëshkohen me sanksione sipas specifikimeve të bëra në aktet përkatëse, në zbatim të të cilëve del kjo rregullore dhe konkretisht në gërmën “e” të nenit 32 dhe gërmën “b” të pikës 1 të nenit 33 të ligjit nr.9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”;

10. Zbatimi

Ngarkohet Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministri i Shëndetësisë dhe organet e qeverisjes vendore për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj rregulloreje.

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Lufter Xhuveli

MINISTRI I SHËNDETËSISË
Nard Ndoka

SHTOJCA 1
LLOJET E MBETJEVE SPITALORE TË RREZIKSHME

Kategoria e mbetjeve	Përshkrimi dhe shembuj	Zonat kryesore prodhuese
18 01 01	Instrumente të mprehta (përveç 18 01 03) Instrumente të mprehta të përdorura, si për shembull age, shiringa, bisturi, brisqe, pajisje të përziera, qelqe të thyera dhe të ndotura, tuba reanimacioni dhe materiale të tjera të ngjashme.	Zona ku ushtrohet kujdesi shëndetësor, salla operacioni, laboratore dhe qendra kërkimore, banka gjaku, qendra për mbledhjen dhe transfuzionin e gjakut, qendra dialize.
18 01 02	Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03), produktet e gjakut; sende të ndotura me gjak serume dhe plazëm; kultura dhe grumbullime të agjentëve infektues që krijohen nga laboratore kërkimore dhe diagnostikimi dhe materiale të ndotura me agjentë të tillë; mbetje izolimi nga pacientë me koeficient infektimi të lartë; mbetje të mjekimeve dhe të vaksinave; mbetje, shtresa dhe materiale të tjera të infektuara me patogjenë trupore.	Salla operacioni dhe zona kirurgjikale, morgje dhe qendra për realizimin e autopsive, materniteteve dhe klinikave obstetrikale.
18 01 08	Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të përballuar infeksionet; Mbetje që përmbajnë substanca kimike: Për shembull, kimikate të ngurta, të lëngshme ose në gjendje të gaztë sikurse solventët, reagentët, dizinfektuesit që kanë skaduar ose që nuk nevojiten më, zhvilluesit e filmave, oksid etileni dhe produkte të tjera kimike që mund të jenë toksikë, gërryes, që digjen lehtësisht, shpërthyes ose kancerogjenë. Ilaçe të skaduara të të gjitha llojeve, sikurse dhe mbetjet e tyre që mund të jenë gjenotoksike, mutogjene, teratogjene ose kancerogjene; sende të ndotura ose që mbajnë produkte farmaceutike (shishe, kuti).	Zona ku ushtrohet kujdesi shëndetësor, salla operacioni, laboratore dhe qendra kërkimore, banka gjaku, qendra kirurgjikale për mbledhjen dhe transfuzionin e gjakut, qendra dialize, qendra laboratorike dhe kërkimore, qendra shëndetësore, dentistë.
18 01 10	Ilaçe citotoksike dhe citostatike; Mbetje amalgame të kujdesit dentar; Kontenierë në presion; Cilindra që mbajnë gazra ose aerosole që kur shpohen ose digjen aksidentalisht mund të shpërthejnë. Cilindrat	Zona ku ushtrohet kujdesi shëndetësor, depo farmaceutike dhe kimike, dentistë, laboratore,

	mund të përmbajnë gazra të përdorura për qëllime shëndetësore, dhoma të nxehta ose për përgatitjen e mjekimeve.	zona ku ushtrohet kujdesi shëndetësor, depo farmaceutike dhe kimike, qendra laboratorike dhe kërkimore.
--	---	---

SHTOJCA 2

Modeli Ndërkombëtar i Sinjalistikës që njofton rrezikun e mbetjeve spitalore dhe standardi i etiketimit

Shtojca 2.A Etiketa e kontenitorëve:



Etiketa përfshin shenjën ndërkombëtare dalluese të rrezikut të mbetjes mjekësore, njoftimin e rrezikut mjekësor në shqip dhe në anglisht dhe numrin e parë të klasifikimit ndërkombëtar (6). Madhësia minimale e etiketës duhet të jetë 14cm x 14cm dhe të ketë formën e një rombi.

Shtojca 2.B Etiketa e koshave

Të gjitha etiketat duhet të prodhohen me materiale që u rezistojnë rrezeve UV, ujit dhe të jenë ngjitëse.

Etiketa që duhet të vendoset në pjesën e prapme të koshit:



Etiketa përfshin shenjën dalluese të rrezikut të mbetjes mjekësore ndërkombëtare, njoftimin e rrezikut të mbetjes mjekësore në shqip dhe anglisht dhe numrin e parë të klasifikimit ndërkombëtar (6). Madhësia minimale e etiketës duhet të jetë 14cm x 14cm dhe të ketë formën e një rombi.

Etiketa që duhet të vendoset në pjesën e përparme të koshit:

Etiketa dalluese duhet të përcaktojë me germa të mëdha llojin e mbetjes së rrezikshme, përshkrimin shtesë me germa të vogla dhe duhet të mbajë shenjën dalluese të rrezikut. Madhësia minimale e etiketës duhet të jetë (Gjerësi x Lartësi) 14cm x 5cm. Etiketa duhet të jetë shkruar në gjuhët shqip dhe anglisht.



Etiketa përshkruese përfshin:

- Përshkrimin dhe identifikimin (me germa të bardha në një sfond të zi), “Mbetje spitalore”
- N.O.S.
- Përcaktimin “I infektuese”;
 - Fjalën sinjalizuese “RREZIK”;
 - Njoftimin e rrezikshmërisë “Mund të shkaktojë infeksion”;
 - Numri i OKB “3291”¹;
 - Klasën e rrezikut “6.2”;
 - Numrin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve “18.01.03*”;
 - Numrat EINECS ² ;
 - Shprehja e rrezikut “R21”;
 - Shprehja e sigurisë “S1/4/24/35/36/37/431 /60”;
 - Deklaratë paralajmëruese;
 - Identifikimi i furnizuesit;
 - Personi i kontaktit;
 - Adresa;
 - Numri i telefonit dhe celularit;
 - Madhësia minimale duhet të jetë (Gjerësia x Lartësia) 21 cm x 14 cm (A5). Etiketa duhet të jetë shkruar në gjuhët shqip dhe anglisht.

¹ përfaqëson numra katërshifrorë që identifikojnë mallrat e rrezikshme, substancat dhe artikujt e rrezikshëm etj., që përcaktohen nga Komiteti i Eksperteve të OKB-së për transportin e mallrave të rrezikshme

² EINECS kuptohet një numër regjistri i dhënë për çdo substancë kimike të tregtueshme, marrë nga Inventari European për Substancat Kimike Ekzistuese

Mbetjet mjeksore
N.O.S
MEDICAL WASTE
N.O.S

Infektuese
Infectious

Fjala sinjalizuese: **RREZIK**
Signalword: **DANGER**

Shprehja e rrezikshmerise: **mund te shkaktoje infeksion**
Hazard Statement: **may cause infection**

Nr. i UNi / UN - Number: **3291**
Klasa / Class: **6.2**
Katalogu i Mbetjeve:
Waste Catalogue: **18.01.03***

Nr. i EINECSi / EINECS Nr.:

R – Frasa / R - Phrase: **R21**
S – Frasa / S - Phrase: **S1/4/24/35/36/37/43₁/60**

Shprehja parandaluese / Precautionary Statement:

Identiteti i furnizuesit / Supplier Identification:

Personi i Kontaktit / Contact Person:

Adresa / Address:

Numri i Telefonit / Tel Number:

Etiketa e “Destinacionit dhe e deklarimeve”

Çdo kosh i ambalazhuar, i mbyllur dhe vulosur duhe të identifikohet me një etiketë që duhet të vendoset në unazën e vulës dhe që tregon:

- Vendndodhjen;
- Gjendjen e ngurtë ose të lëngët;
- Llojin e mbetjes së rrezikshme;
- Datën e grumbullimit;
- Numrin e koshit ose ambalazhimit;
- Sasinë në kg ose litra;
- Nënshkrimin e punonjësit të grumbullimit.

Qendra e Menaxhimit të Mbetjeve e Rrezikshme			
LOKATION.....			
Te ngurta	<input type="checkbox"/>	Te lëngshme	<input type="checkbox"/>
Bateri	<input type="checkbox"/>	Vaj i përdorur	<input type="checkbox"/>
Bateri Makinash	<input type="checkbox"/>	Acid	<input type="checkbox"/>
Filter	<input type="checkbox"/>	Alkali	<input type="checkbox"/>
Pesticide	<input type="checkbox"/>	Pesticide	<input type="checkbox"/>
Kimikate	<input type="checkbox"/>	Kimikate	<input type="checkbox"/>
Pleh	<input type="checkbox"/>	Pleh	<input type="checkbox"/>
		Te ngurta	<input type="checkbox"/>
		Te lëngshme	<input type="checkbox"/>
		<input type="checkbox"/>
		<input type="checkbox"/>
Numri i Kazaneve:			
Pesha:kg / litra			
Data e grumbullimit:		Kontrollimi i kualitetit:	
.....		

SHTOJCA 3

Metoda alternative për trajtimin dhe asgjësimin

Trajtimi fizik, si:

1. Autoklava;
 - a) Presion;
 - b) Presion – avull;
2. Sterilizimi me mikrovalë;
3. Sterilizimi – UV;
4. Trajtimi kimik/dizinfektimi;
 - a) me shkumës të kloruar;
 - b) me klor aktiv (klor të lirë);
 - c) me peroksid hidrogjeni (H_2O_2);
 - d) me glutinimin e proteinave nëpërmjet përdorimit të acideve;
 - e. me ozon (O_3);
5. Metoda asgjësimi, si:
 - a) asgjësimi

Të gjitha mbetjet spitalore infektuese, që asgjësohen bashkërisht në vendet ekzistuese të asgjësimit ose në venddepozitimet e ardhshme të mbetjeve spitalore, duhet të vendosen në vendin e caktuar dhe të mbulohen me material izolues. Ndalohet manipulimi i materialit dhe kontakti fizik.

- b) Izolimi në kontenerë dhe sisteme teknike të provuar ndërkombëtarisht;
- c) Çimentimi dhe imobilizimi i tyre.

SHTOJCA 4

KUSHTET QË DUHET TË RESPEKTOJË TRANSPORTIMI I MBETJEVE SPITALORE INFEKTUESE

Përveç automjeteve të urgjencës që kthehen nga vende aksidentesh, çdo automjet që transporton mbetje spitalore infektuese duhet të jetë lehtësisht i identifikueshëm gjatë transportimit të mbetjeve me shenjën dalluese ndërkombëtare të rrezikut të mbetjes mjekësore dhe fjalët e përshkruara në shtojcën 2.

Automjetet e përdorura për transportin e mbetjeve spitalore infektuese:

- Duhet të përfshijnë një pjesë ngarkues – transportues që rri i mbyllur dhe i siguar, përveçse kur ngarkon ose shkarkon mbetje spitalore për të parandaluar hyrjen dhe ekspozimin e paautorizuar ndaj erës dhe rreshjeve;
- Duhet të jenë projektuar dhe ndërtuar në mënyrë të tillë që të mos lejojë derdhjet;
- Duhet të jenë pastruar dhe dizinfektuar pas rrjedhjeve ose derdhjeve aksidentale;
- Duhet të jenë pastruar dhe dizinfektuar para përdorimit për ndonjë qëllim tjetër; dhe
- Nuk duhen përdorur për të transportuar ushqime, produkte ushqimore, kontenerë ushqimorë ose ndonjë substancë, e cila do të gëlltitet nga njerëzit ose kafshët ose do t'i shtohet ushqimeve të njerëzve ose kafshëve.

Gjatë transportimit të mbetjeve spitalore infektuese, automjetet duhet të mbajnë me vete një kit për ndalimin e derdhjeve dhe për pastrimin e automjetit.

Çdo derdhje prej njëzet (20) ose më shumë kilogramësh, duhet të raportohet sa më shpejt që të jetë e mundur te punëdhënësi, Inspektorati Sanitar Shtetëror, inspektorati mjedisor, sikurse dhe tek organi kompetent i qeverisjes vendore. Çdo kontakt direkt i mjetit ose pajisjes me mbetjen spitalore duhet të konsiderohet dhe trajtohet si derdhje.

SHTOJCA 5
STANDARDE TEKNIKE PËR DJEGIEN E MBETJEVE SPITALORE INFEKTUESE

Standardet teknike për djegien e mbetjeve spitalore të rrezikshme janë ato standarde të përcaktuara në tabelën 6.1 “Krematori” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”.

a) Mbetjet e rrezikshme spitalore do të digjen në impiante me një fuqi kalorike jo më të vogël se 11 000 kJ/kg DS;

b) Ndalohet djegia e mbetjeve të rrezikshme në impiante me fuqi më të vogël kalorifike se 350 kë.

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.**

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. REGJISTRAT E NOTERISË
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PUNËS

KODI I FAMILJES

PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat

Hyri në shtyp më 1.2.2008
Doli nga shtypi më 1.2.2008

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
Tiranë, 2008

Çmimi 40 lekë